

# Oral History Kosovo

## INTERVISTË ME PAJAZIT NUSHIN

Prishtinë | 25 qershor dhe 31 korrik 2013

Kohëzgjatja: 192 minuta

Të pranishëm:

1. Pajazit Nushi (I intervistuari)
2. Anita Prapashtica (Intervistuesja)
3. Donjetë Berisha (Kamera)
4. Jung Chao (Kamera)
5. Anna Di Lellio

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i/e intervistuari/a shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[ ] - shtesë e tekstit për të lehtesar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që jasin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje

**Anita Prapashtica:** A mund të na tregoni diçka përfmijërinë tuaj?

**Pajazit Nushi:** Po, unë jam sikurse e dini Pajazit Nushi, profesor i psikologjisë. Kam lindur gati para 81 vitesh dhe gjatë kësaj kohe kam kalu faza të ndryshme të zhvillimit në të cilat faza gjithësesi fëmijëria ime zë vend të posaqëm. Kam lindur në një qytezë të atëhershme n'Gjakovë, e cila për kuptimet e mia të asaj kohe, por duke gjykuar tash për atë kohë, ka qenë ndër vendet me zhvillim mesatar të nivelit kosovar, por me zhvillim të ulët në krahasim me vendet tjera. Kam lind në një familje tregtarësh. Prindërit e mi dhe paraprindërit e mi kanë qenë tregtarë dhe kanë qenë të ardhur nga viset e Serbisë së atëhershme, kur rrëth viteve 1780 osht' bërë shpërngulja e shqiptarëve. Familja e ime sipas thënjeve të prindërve të mi osht' shpërngulur dhe të gjithë kanë qenë të vrarë gjatë shpërnguljes me përjashtim të një fmije të vogël që i ka shpëtu vdekjes. Dhe e paskan marrë përritje dhe për kujdes një familje pasanike me mbiemr Nushi. Përndryshe mbiemri i im i vërtetë i familjes sime nuk osht' Nushi, po paska qenë Shyti. Por pëarsye se ky fëmijë paska pas qenë rritur në familjen Nushi, atëherë edhe mbiemri i ynë paska pas kalu në Nushi.

Sipas kujtimeve të mia në atë kohë kemi pas në Gjakovë vetëm dy familje të cilat i kanë taku trungut familjar të mirëfillt Nushi. Me fjalë të tjera në Gjakovë kemi pas, edhe në Kosovë kemi pas edhe familje të tjera me mbiemnin Nushi. Madje kemi edhe familje të fesë tjetër, të fesë katolike me mbiemnin Nushi. Këta të të fesë katolike kanë qenë pjestarë të familjes sonë, kështu janë konsideru dhe na kanë vizitu edhe i kemi vizitu, kemi majtë miqësi të ngushtë prej asaj kohe edhe sot. Një numër i madhë i antarëve të kësaj familje edhe sot ndodhen në familje në Vranic, në fshatin Vranic të rrëthit të Gjakovës me mbiemnin Nushi. Pavarësisht prej ndryshimeve fetare, ajo çka osht' karakteristike që më ka mbetë në kujtesë, si kujtim i qëndrueshëm osht' se nuk kemi bo dallime a i përkasin fesë katolike apo fesë islame.

Përndryshe prindërit e mi kanë qenë fetarë, i kanë taku fesë islame, kanë qenë fetarë të bindur në predikimet e pejgamerit Muhamed. Kanë qenë fetarë të cilët i kanë zbatu jo vetëm rregullat fetare të islamizmit por njëkohësisht kanë qenë miqë të ngushtë me udhëheqësit fetar të Gjakovës. Kështu bie fjalë, në fëmijërin time kemi pas vizitues të familjes, nga hoxhallarët ma të njoftun të Gjakovës, qysh ka qenë, në atë kohë e qujshim Fahri Efendia. Njohës i mirë i fesë, Kur'anit, drejtor i medreses në Gjakovë dhe

njeni që ka kry ose ka knu Kuranin më s'miri në Tunizi me rastin e promovimit të mbretit të Tunizisë në vitin 1964, osht' dallu si fetar i lartë. Prindërit e mi kanë majtë lidhje të ngushtë me këta fetar.

Kurse nana ime ka qenë bijë e një shehu të njohtun në Gjakovë, e osht' qujtë, ai sheh haxhi sheh Musaja, krijus i sektit Rrufai<sup>1</sup> në Gjakovë dhe në trevat shqiptare përgjithësisht. Prej këtij sekti Rrufai janë kriju teqe të ndryshme në Rahovec, në Prizren, në Shkodër, në Elbasan, në Durrës dhe në vende të tjera. Por themelimi i këtij sekti osht' në Gjakovë. A nana ime ka qenë bijë e këtij shehi, që osht' themelues i sektit ose i rendit të dervishëve të qujtur Rrufai. Edhe sot kjo teqe osht' e njojur edhe ka.... gëzon një autoritet të fuqishëm jo vetëm në Kosovë por edhe në vende të tjera, në Kosovë edhe jashtë, jashtë Kosovës sidomos në Shqipëri.

Fëmijëria ime, mund të them se ka qenë fëmijëri, sot e vlerësoj... fëmijëri në kushte dhe në raporte të randa ekonomike-sociale dhe përgjithësisht politike. Unë kam lindur në vitin 1933 kur Gjakova edhe Kosova kanë qenë nën mbretërin serbo-kroato-sllovene. Dhe në atë kohë mësimet e para unë i kam marrë në gjuhën serbishte. Kam qenë në një klasë që në atë kohë quhej klasë përgatitore, përfmitem që nuk e kishin gjuhën serbe gjuhë amtare, e që qëllimi ishte përgatitja e këtyre fëmijëve për tu aftësu me i ndjek mësimet në gjuhën serbishte.

Mirëpo kjo ishte në vitin 1939 kur unë i kasha vetëm 6 vjet, menjëherë në vitin 1940 u shkaktun trazira të lidhura me fillimin e Luftës së Dytë Botërore. Edhe me këtë rast, Gjakova edhe një pjesë e Kosovës osht' inkadru në të ashtu quajturën mretri [mbretëri] shqiptare nën kurorën e mretit [mbretit] të Italisë, të Etiopisë edhe të Shqipërisë, perandorit princ Emanueli i III-të. Kështu osht' qujt', i kam të qarta figurat e këtij mreti në dhomat e msimit në klasë ku kemi zhvillu mësim.

Ka qenë një kohë të cilën sot e çmoj, kohë e përpjekjeve shumë të mëdha të shqiptarëve sidomos të Gjakovës, por dhe të Kosovës për bashkim me Shqipëri e këto ndryshime politike i'u kanë konvenu shumë tepër shqiptarëve të asaj kohe. Kemi pritur shumë me fjalë tjera edhe prindërit e mi kanë pritur shume prej këtij bashkimi, sepse babai im ka qenë adhurues i madh i mretit Zog, i mretit të Ahmet Zogut - pavarësisht që ka jetu në atë kohë në Kosovë, përkatësisht në ish mbretërinë serbo-kroato-sllovene, ai i ka përcjell me kujdes shumë ma të madh lëvizjet në Shqipëri se sa që i ka përcjell lëvizjet në Kosovë dhe në Gjakovë.,

Kurse nana ime ka qenë... po flas për në atë kohë, ka pas vëllaun e vetë, po ashtu fetar të lartë, i quajtur sheh Ademi, themelues i disa teqeve në Shqipëri, në rend të parë në Shkodër mandej në Elbasan, mandej në Peqin, e prej andej osht' ardhë edhe osht' vendosur në fshatin Gri, buzë kufirit të Shqipërisë, me të thonë, një shtatë-nantë kilometra përtej kufirit të atëhershëm serbo-kroat, mretri e Shqipërisë. Dhe unë si fëmijë me nanën time kemi kalu tri ditë, një javë disa herë në Shqipëri, në fshatin Gri, ku ka qenë i vendosur vëllau i vetë me familje të vetë kuptohet, edhe me institucionin fetar të vetin.

---

<sup>1</sup>Rrufai, një vëllazëri Sufi, e themeluar në shekullin e XII afér Basrasë në Irakun, e sotëm.

Shkollimin fillor timin e kam fillu në praninë e pessë motrave të mia, kom qenë i lindur pas pesë motrave. Dhe këto të gjitha, sidomos motra e dytë ende osht' gjallë, ka qenë nxanëse e shkëlqyeshme e shkollës filllore serbe në atë kohë të Gjakovës. Dhe prej asaj kam mësu si duhet bërë përpjekje për ta zotëru gjuhën tjetër, për t'i zotëru landët e mësimet në shkollë filllore etj, etj. Gjatë gjithë kësaj kohe nuk du t'a heki prej emnuesit të përbashkët, edukimi fetar dhe moral ka qenë edukim dominues në familje dhe në mjedisin tonë farefisnor, në mjedisin prej dy familjeve. E quaj mjesdis prej dy familjeve sepse dy vëllezërit, baba im edhe axha im, kanë jetu me shpija në të njëjtën rrugë të ndarë njëri prej tjetrit por në të njëjtën rrugë. Dhe, për ndryshim prej familjes sime që kemi qenë në nivel ma të ulët ekonomik për mos me thon nivel i varfër, axha im ka qenë pasanik. Nuk di ta shpjegoj origjinën e plotë pse kanë ardhë deri te këto ndryshime, por osht' e vërtetë se ne në familjen tonë duke përfshirë mu' edhe tjerët kemi jetu në kushte ekonomike relativisht të dobëta të asaj kohe.

Mund të them se shkollimi im në fillore ka qenë në gjuhën shqipe i kryer edhe i organizuar nga nga mësuesë kryesishët të ardhur nga Shqipëria. Mësuesit e mi të parë kanë qenë tre mësues prej Shkodre, një mësuese prej Elbasanit. Dhe ne në atë kohë jemi eduku edhe mësu nën sistemin edukativ-arsimor që ka pas mbretëria shqiptare e asaj kohe nën të cilën kemi qenë edhe ne.

Unë bie fjala si fëmijë më kujtohet kam qenë nxanës i klasës së dytë të shkollës filllore "Bajram Curri" në Gjakovë, kur e kemi pritur për herë të parë kryeministrin e Shqipërisë Mustafa Krujën. Kemi qenë si fëmijë të veshur në brekë [pantollona të shkurtër] të ngjyrës së zezë dhe këmishë të ngjyrës së kuqe. Qysh prej asaj kohe nuk e kam të qartë qysh kam qëllu në rendin e atyre fmine që prej kryeministrit kemi kërku që në Gjakovë të mos themelohet Instituti Tregtar, qysh ka pru vendim qeveria e Mustafa Krujës, por në Gjakovë të themelohet shkolla normale për mësuesë. Kjo ka qenë kërkësë e atij mjesdisi në të cilin kam qëllu edhe unë. Por nuk di ma teper a kam qëllu rastësisht apo na kanë fshi qashtu edhe unë kam qëllu aty, këta nuk e kam të qartë as nuk mund të flas.

Por e di njeriun e kam mik të ngushtë, Vehap Shitën, ju do të bisedoni me të, ai ka qenë kërkues i ndryshimit të këtij vendimi të qeverisë së atëherëshme të Shqipërisë, që Gjakova vend i varfër, vend në të cilin në atë kohë ka pasë disa rrobaqepës, disa këpuctarë, disa mbathtarë kuajsh, zdrukthtarë, bujqësia ma e madhe, nuk di pse kanë pru vendim për ta themelu Institutin e Tregtisë kur gjithëçka tjetër ka qenë e zhvilluar ma tepër, kurse tregtia s'ka qenë e zhvilluar, sepse nuk ka pas kush me kend të zhvillojë tregti. Dhe për çudi shumë të madhe, kjo kërkësë e asaj kohe osht' realizu.

Edhe në Gjakovë, në vend të themelimit të Institutit të Tregtisë, osht' themelu shkolla normale, në të cilën kanë dhanë mësim... Drejtor i parë i saj ka qenë Zekria Rexha, profesor i filozofisë që mua më ka dhënë mësim ma vonë kuptohet, por e maj në mend fort mirë. Me personel arsimor me fjalë të tjera të cilët kryesishët kanë qenë mësues, me përjashtim të këtij drejtorit që ka qenë profesor jo i krym në Paris, por ka kry studimet në Paris për filozofi të thjeshtë e ka diplomu në Beograd shumë kohë mësaj që unë po flas. Mirëpo ka qenë një personalitet me autoritet të njohur të asaj kohe, me nivel shkollimi shumë të lartë që në atë kohë nuk kemi pas ne në Gjakovë as në Kosovë. Ka qenë ma vonë edhe personalitet politik, ka

marrë pjesë në konferencën e Bujanit ku osht' vendosë për herë të parë që shqiptarët e Kosovës dëshirojnë të bashkohen me Shqipëri. Në vitin 1942 edhe 1943, me 31 dhjetor '42 dhe me 1 e 2 janar '43, osht' mbajtë kjo konferencë e Bujanit, për të cilën Vehap Shita mund të iu flet ma shume, se sa qe mund të iu flasë une se une teoritikisht e di, ai praktikisht ka vepru në atë kohë

Kom qenë edhe si fëmijë përkrahës i lëvizjes nacionalçirimitare antifashiste. Kom marrë pjesë në demonstrata të 28 nëntorit të vitit 1942. Si fëmijë i moshës nontë përkatësisht dhjetë vjeçare, kom bartë materiale konspirative. Materiale të shkruara të lëvizjes antifashiste prej një familjeje në familjen time e kryesisht prej mësuesve të mi te daja im që ka qenë fetar, ka qenë sheh në teqen rrufai, por përkrahës i lëvizjes antifashiste nacionalçirimitare. Mësuesit tanë të asaj kohe po e përsëris ndoshta, kanë qenë jo vetëm të ardhur prej Shqipërisë por kanë qenë mësues të formum në të njëjtën shkollë, në shkollën normale të Elbasanit, shkollë e vetme e shqiptarëve për formim të personelit arsimor në gjuhën shqipe. Dhe ata të gjithë pa përjashtim kanë qenë atdhetar të mëdhenjë, na kanë eduku në fryshtë e atdhetarizmit të fuqishëm të asaj kohe. Përndryshe, nuk kish me qenë e njohur as fëmijëria ime as e gjeneratës sime sikur mos ta them këtë se osht' nji e vertetë, e vertetë e madhe.

Landët e muzikës, kongt ishin kongë atdhetare, landa e vizatimit ishte lidhur me atdhetarizëm, flamuri qysh mund të vizatohet me shqiponjë në vizatim. Landa e historisë ish landë dominuese, na jepshin histori që nuk kishim libër por na shpjegojshin në fryshtë e zhvillimit të historisë së kombit shqiptar. Prej knej edhe mund ta shpjegoj edhe qëndrimin tim pozitiv ma vonë politik që ka lindë gjatë gjithë jetës sime që kam qenë i angazhuar në funksione politike, prej komunës së varfér Gjakovë, në rrëthim pak ma të zhvilluar në qark të Prizrenit, angazhimet politike në funksione në nivel të Kosovës edhe në nivel të Federatës Jugosllave.

Gjatë kësaj kohe, po flas për kohë të fëmijërisë sime, e ajo osht' kohë qysh iu thash që mbaj mend unë prej 38-ës, 39-ës deri 44-tën, 45-tën kur e kam kry klasën e pestë të shkollës fillore, këtë e quj' fëmijëri time. Klasën e pestë të shkollës fillore e kam kry në vitin 1945, në prag të përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Ka qenë nji prej provimeve ma të vështira që kam kalu unë gjatë gjithë kohës së shkollimit edhe të studimeve edhe të doktoraturës sime. Kemi pas të formuar komision provues prej Ministrisë së mbretërisë shqiptare, kryetar prej Tirane. Kanë qenë të rreshtuar të gjithë mësuesit, edhe kemi pas provim me shkrim, hartim prej gjuhës shqipe edhe prej landës aritmëtike qysh e kemi quajt' në atë kohë. Ata që kalojshin prej këtyre dy landëve me shkrim kishin të drejtë me hy në provime me gojë.

Jepshim provim në gjuhën shqipe në drejtshkrim, diktim, hartim, fonetikë edhe sintaksë, po ashtu jepshim provim edhe në aritmëtik me gojë. Ma vonë i nënshtroheshim ditëve të tjera, provimit nga njohuria shoqërore edhe nga dituria natyrore, keshtu quheshin. Edhe në fund i kishim një grup të landëve të mësimit që në atë kohë quheshin shkathtësi, e që bëjshin pjesë bukurshkrimi, muzika, vizatimi edhe punëtorja, kështu kanë qenë landë të mësimit të asaj kohe.

Sai i përket muzikës diçka fola, por ajo që osht' më me rëndësi e që nuk e thash osht' kjo, prej asaj kohe më ka lindë dëshira, tendenca e të marrurit me muzike edhe gjatë gjithë kësaj kohe të jetës sime kam kalu si instrumentalist si kangtar i mire. Edhe atëherë kur nuk kam pas mundësi ose kur nuk kam pas za përt'knu, unë kënaqem me pjesëmarrjen time në koncerete muzikore, në koncerete artistike të niveleve të ndryshme, por në rend të parë të muzikës jo veq popullore, të muzikës së përpunuar popullore, të muzikës artistike etj etj. Edhe sot jam...prej të gjitha fushë-veprimeve të mia kurrë njëherë nuk jam nda prej muzikës dhe gjithmonë kam anu kah krijuimtaria muzikore. Këtë me sa kuptoj unë e kam si prodhim, si produkt edhe të familjes sime edhe të dajës sim, të cilët kanë muziku si me thanë, në pikëpamje fetare. Por kanë përdorë instrumente, kanë përdorë mandolinë që në atë kohë, po flas për vitin 1942, '43, '43, mandolinë mund të ketë pas në Gjakovë në katër- pesë familje të pasura.

Të gjitha këto kisha me i mbyllë me një fjali përkujtuese sa i përket fëmijërisë sime. Unë prej kësaj fëmijërie kam pas përfitime, konstatoj tash që kam pas përfitime shume të mëdha. Unë gjuhën shqipe që e kam mësu në atë kohë, ajo më ka shërby si bazë për mësimet e mëvonshme, se më vonë kam mësu serbisht, kam ardhe në një nivel më vonë të shkruj ma mirë, më me pak gabime serbisht se sa shqip, sepse ndikimet e gjuhës, bilingualet të dy gjuhëve, kanë qenë të fuqishme. Dhe mësimi në shkollën në gjuhën serbe nuk ka njoftë fonetikë të shqipes, ose morfologji ose sintaksë se ajo ka qenë gjuhë sllave krejt me një strukturë tjetër, por themellet e gjuhës shqipe të historisë kombëtare, të gjeografisë edhe përgjithësisht të shkencave sociale, unë i kam të vura qysh nga themellet e mësimit fillor, qysh nga femijëria e ime.

Qysh atëherë kam qenë instrumentalist, si fmi i kom ra kitarës, i kom ra mandolinës profesioni im... instrumenti im ka qenë mandolina atë e kemi pas. Atë ka pas mundësi ta sigurojë baba im, edhe atë ma qartë ma ka falë daja im. Instrument tjetër edhe sikur të kisha ditë, nuk kemi pas në atë kohë, unë bie fjala për herë të parë kam mësu se ç'osht' piano, ç'osht' klaviri kur e kam vizitu kishën e Deçanit. Kom pas pa edhe kush i bjen një instrumenti të cilin isha mbetë i habitur si fmi, paska edhe kësi far lloj instrumenti që po e qitka gjithë kishën e Deçanit, gjithë manastirin e Deçanit.

Kom nji vërejtje në sistemin shkollor të asaj kohe, nuk na kanë mësu t'i zotrojmë gjuhët e huja. Gjuhët e huaja zotërohen në fëmijëri, vështirë osht' ma vonë të zotërohen gjuhët e huaja. Ne në atë kohë nuk kemi pas gjuhë të huaj, kemi msu spontanisht serbisht sepse kemi pas shokë, kemi pas familje, kemi pas të njohur prej familjeve serbe edhe ata kanë mësu shqip prej nesh, por me msu frëngjisht, me msu italisht, se italianët kanë qenë në atë kohë pushtues, me mësu gjermanisht, në sistem shkollor të asaj kohe nuk ka pas. Vishin herë mas here të na mësojnë disa mësues italisht, kur ikën italianët filluan të na mësojnë gjermanisht, por mësim sistematik të gjuhëve të huaja në fëmijërinë time, gjenerata e ime edhe unë së bashku me ta, nuk kemi pasë. Kjo osht' nji prej të metave shumë të mëdha të asaj kohe të cilën unë nuk e arsyetoj. Nuk e arsyetoj për arsyen se ka pas edhe arsimtarë kemi pas edhe mundësi që ta zotrojmë njënen prej gjuhëve të huaja sepse sundimi italian bonte tregti vetëm në gjuhën italishte por jo edhe në gjuhë të tjera. Italianët nuk dishin shqip, gjermanët në gjuhën gjermanishte por jo në gjuhën shqipe ata,

nuk kanë ditë shqip. Megjithkëtë, unë për vete flas më ka mbetë si vërejtje e fëmijërisë sime të cilën nuk kam pas mundësi ta mësoj një gjuhë të huaj e të shkoj bie fjala në studime me njohjen elementare të të një frengjishte, të një italishte, të një gjermanishte, të një shka po di unë, të një turqishte.

Ata që e kanë viju medresen, bie fjala në Gjakovë disa prej shokëve të mi kanë mbrri të mësojnë arabisht. Medresa ka qenë një mur i ndarë prej familjes sime, prej shpisë sime. Unë nuk i kom viju mësimet në medrese fetare, i kam viju mësimet në shkollë shtetërore, në shkollim fillor shtetëror. Më kujtohet po ashtu se shumë vetë që nuk dishin gjuhën shqipe që ishin të rritur, të pjekur, burra të ri, vishin me mësu në shkollë ku mësojsha unë natën alfabetin e gjuhës shqipe. Me mësu qysh shkruhet e qysh lexohet në gjuhën shqipe, se kishin msu vetëm në gjuhën arabishte, ma tepër në gjuhën sllavishte në gjuhën serbishte.

Ajo që osht' më karakteristike për fëmijërinë time osht' se në klasën time konkretisht, shumica dërrmuese kemi qenë meshkuj. Femra nxanëse ka pas pak, edhe ato që kanë qenë, uleshin në një rresht krejtësisht të ndarë të bankave shkollore. Dihej sa osht' rreshti i femrave edhe ne me atë rresht nuk komunikojshim as ato me ne nuk komunikojshin, kështu ka qenë rendi. Kur hyshim në klasë të mësimit vinte ora me hy, binte zilja një komon<sup>2</sup> në dorë i mëshonte kuriri, shërbëtori i shkollës, lajmronqe që duhet m'u bo rresht. Baheshim rresht, dy-tri rende të para prej dy- tri vetash ishin femra nxanëse, na tjerët ishim meshkuj, gjithmonë u rreshtojshim mbas tyre edhe të ndara prej tyre. Kështu ka qenë sistemi i asaj kohe madje edhe kur shkojshim në ndonjë ekskursion një ditor se nuk kemi pas atëherë ekskursione. Femrat nxanset, ose vishin ose s'vishin, pjesa ma e madhe nuk vinte. Edhe ato që vishin, krejtësisht ishin të ndara prej nesh, ato komunikojshin mes veti ne në mes veti. Kështu ka qenëjeta e asaj kohe edhe e gjeneratës sime përgjithësisht.

Edhe një cilësi tjetër, në mesin e landëve të mësimit kemi pas edhe mësim besimin, mësim fetar. Na jepte neve që ishim mysliman një hoxhë, e ata që ishin katolikë u jepte një prift katolik, kemi pas dy orë në javë mësim fetar dhe moral, kështu quhej. Mësim i rregullt, sistematik në shkollë filllore. Nuk kemi pas libra për mësime fetare, edhe librat për landë t'jera kanë qenë te kufizuara por megjithatë kishim një libër të gjeografisë. Kishim një libër për mësim të natyrës por për landë të tjera libra nuk kemi pas, ma tepër me shënimë mbajshim ose na diktojshim arsimtarët. Për mësimin fetar e kemi pas një revistë të posaqme, si na si dhe katolikët, botohej në Tiranë ajo revistë edhe kish predikime fetare që u duhej t'i mësonin përmendësh. Mund të mësonim për të marrë abdes, për t'u falë dhe për t'i kry ato predikimet tjera fetare. Po ashtu shokët e mi katolikë mësojshin prej librave të tyre në gjuhën shqipe, me sa më kujtohet ishin këto libra të botuara në Shkodër për ndryshim prej librave tona, të myslimanëve që ishin të botuara në Tiranë.

---

<sup>2</sup>Komoni është një lloj zileje që i është vënë lopes në qafë.

Motrat e mia në ndërkohë kanë qenë të martuara, derisa unë kam qenë në moshën e fëmijërisë. Por të martuara në mënyrën e atëherëshme me anë të mësитnisë, të martuara kryesisht ndër familjet që ishin relativisht më të pasura se sa që ishim ne. Motra ime e madhe bie fjala, ka qenë e martuar për një burrë që veq kishte gru po s'kishte fëmijë. Familja e burrit të motrës sime ka qenë familje e pasur, familje tregtare dhe jam i sigurt që nëpërmes të këtij relacioni, pasuri osht' dhënë edhe motra ime 21 vjeçare për burrë 49 vjeçar me sa më kujtohet. Fati i saj ka qëllu i atillë, lindën fëmijë. Tash fmitë e saj edhe kanë vdekë por u kriju një familje shumë e madhe.

Nji prej fëmijëve të saj bie fjala osht' profesor i njohur i matematikës në Universitetin e Prishtinës, osht' doktor i shkencave të matematikës quhet Minire Efendia njeni prej tyre. Tjetri ka qenë një ekonomist i njohur i cili u vra gjatë operacioneve luftarake të mëvonshme. Nuk dihet as kush e ka vra as, pse u vra as pse u zhdukë as, por dua ta tregoj fatin e tyre.

Motra ime e dytë e cila ishte e njohur si nxanëse e shkëlqyeshme por edhe e zhdërvjelltë, mund të them sot, ka pas fuqi intelektuale më të lartë se sa që kemi pas ne të gjithë, duke përfshi edhe prindërit e mi. Ajo bie fjala ka ditë me bo tregti në atë kohë me meshkuj me femra me i siguru jetë familjes. Ajo osht' gjallë sot, ka gati 90 vite, osht' në moshë të shtyer por e ka kujtesën relativisht të zhvilluar. Ka kriju edhe ajo familje, ka nipa, mbesa, stërnipa etj, etj. Edhe një gja duhet të iu them edhe me këtë t'a mbylli këtë kohë. Çudi shumë e madhe prej familjes sime qe kanë qenë e një sektit fetar të veçantë, sektit rrufai, motrat e mia kanë qenë të dhanuna [martuara]. Kjo e madhja në një familje të hoxhallarëve që nuk kanë pranu sekte, kjo e dyta në një familje të të njëjtit sekt që ka qenë babai im edhe nana ime. E treta ka qenë e dhanun [martuar] për një sekt tjetër, sektin kadri<sup>3</sup>, e katërt ajo ka qenë e dhanun [martuar] për një familje e sektit bektashij. Por megjithatë, vërtetë unë edhe sot flas me krenari një lidhje e ngushtë që nuk osht' hetu ky dallim në mes përkatësisë së sekteve në familje. Kemi pas relacione shumë të mira familjare me të gjitha keto familje dhe farefisnin e tyre që i kanë taku sekteve të ndryshme fetare, këtu kisha me vu pikë, në këtë...

**Anita Prapashtica:** Profesor na tregut për shkollën fillore, a mund të tregoni diçka për shkollën e mesme?

**Pajazit Nushi:** Pas përfundimit të klasës së pestë të shkollës fillore, jepshim njëfar lloj provimi që quhej provim i *lirivit*, provim para komisionit shumë serioz. Edhe ai që kalonte nuk kishte obligim më vonë për t'i viju mësimet, por me përfundim të këtij provimi Lufta e Dytë Botërore përfundoi, edhe hyri një system i ri në shkollim, sistem që quhej sistemi i progjimnazit dhe i gjimnazit. Unë jam regjistrues në klasën e dytë të gjimnazit të asaj kohe sepse ma kanë pranu klasën e pestë si klasë të parë të gjimnazit, menjëherë kam viju mësimin në klasën e dytë gjimnaz. Aty e kom has edhe një gjeneratë para meje që e ka kry...veç e kishte kry klasën e parë gjimnaz. Ata kishin një klasë të veçantë që quhej klasa A, 2A ne ishim 2B, kishim lidhje të ngushtë por dallimet moshore ishin të mëdha, bie fjala në mes meje që në klasën e dytë të

<sup>3</sup> Kadiri tarika ose *tariqah* (rrugë/shteg) është një nga shkollat apo urdhërat Sufi më të mëdha. Është themeluar nga Hazrat Sheikh Abd al-Qadir al-Gillani, njeri i shenjtë e i urtë nga Bagdadi.

gjimnazit isha në moshën 12 vjeçare, në klasën e 2A kish nxënës që ish në moshën 18 vjeçare 19 vjeçare. Ato ishin pasojë e luftrave të ndryshme dhe dëshirave të ndryshme individuale të njerëzve dhe e fatit të njerëzve. Unë nuk kam pas ndonjë familje të shkolluar por kam kry shkollën fillore, kam viju menjëherë... ma kanë pranu klasën e pestë si klasë të parë gjimnaz. Kom kalu në klasën e dytë, të tretë, të katërt gjimnaz por, atë që harrova të i'u them qysh prej fëmijërisë kom qenë nxënës i shkëlqyeshëm, me përfundim të shkëlqyeshëm. Dhe këtë përfundim të shkëlqyeshëm i klasës së pestë ma kanë pranu me lehtësi për klasë të parë të gjimnazit, po ashtu edhe në klasën e dytë, klasën e dytë gjimnaz e kam përfundu me sukses të shkëlqyeshëm sikurse edhe klasën e tretë dhe klasën e katërt gjimnaz.

Klasën e katërt gjimnaz e kom përfunduar në vitin 1948, kur sistemi i atëhershëm shkollar e kishte sistemin e organizuar të provimit të semimaturës, të provimit të gjysëm maturës. Unë si nxanës i shkëlqyeshëm kom qenë i lirum prej provimit të semimaturës, nuk kom hy në provim të semimaturës. Por prapë si nxanës i shkëlqyeshëm pata një përfitim të posaqëm se menjëherë kom kalu prej klasës së katërt gjimnaz në klasën e tretë të shkollës normale, dy vite si nxënës i shkëlqyeshëm. Kom kry klasën e tretë edhe klasën e katërt të shkollës normale, po ashtu nxënës i shkëlqyeshëm, dhe si i këtillë kom qenë i caktum prej një komisioni të posaqëm të Kosovës në atë kohë që të shkoj për t'a studiu pedagogjinë.

Nuk kom pranu me shku me studiu pedagogji, kom kërku me këmbëngulje të regjistrohem në studimet e psikologjisë, aty edhe kom mbërrri. Mirëpo, ky ndryshim i landëve tërroqi me veti mos mundësinë e shtetit pér të më dhanë stipendi [bursë nga shteti] pér psikologji, pér pedagogji po, pér psikologji jo. Më kanë majtë prindërit edhe të afërmit e mi, gjatë studimit të vitit të parë edhe të vitit të dytë të psikologjisë eksperimentale në Universitetin e Beogradit. Kom pas fatin të jem më nji gjeneratë, gjenerata e parë e studentëve të psikologjisë në Universitetin e Beogradit mas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, por shumica prej tyre ishin vendas, ishin beogradas qytetarë që kishin kry jo veq studimet, jo veq shkollën e mesme me suksese shumë të larta, por ishin të familjeve që kishin traditë në shkollim. Bie fjala shoku më i mirë i imi serb ka qenë Radoniç, babai i tij ka qenë gjeneral gjatë kohës së Serbisë së vjetër, por gjeneral i shkolluar. Ai i zotëronte gjuhët e huaja frengjishten, spanjishten pér mrekulli, kurse une kurnjë [asnje] prej gjuhëve të huaja. Më ka ndihmu pér së tepërmë [shumë] ky mjedis i shkëlqyeshëm i studentëve të asaj kohe të Beogradit.

**Anita Prapashtica:** Qysh ju kanë pritë juve si kosovar kur keni shku atje, si shqiptar?

**Pajazit Nushi:** Po, kom një përshtypje të posaçme që nuk më kanë dallu fort prej të tjerëve, por nga ana tjetër mund të them se edhe vetë nuk kom qenë prej atyre të izoluarve që kam dëshiru izolimin, por kam kërku vetë të shoqërohem me shokë. E kom pas një, ju tregova, një shok të ngushtë, baba i tij ka qenë gjeneral, ai më vonë u doktoru në psikologji ngeli në degën e psikologjisë në Beograd, dhe osht' pensionu si profesor i rregullt i Universitetit të Beogradit. Një vajzë tjetër bie fjala, Lidia Vuqiq osht' qujtë, nënën e ka pas psikologe doktore të psikologjisë, babën po ashtu doktor të psikologjisë, kështu ka qenë ambienti i atëherëshëm. Gjithësej me sa më kujtohet kemi qenë të regjistrum nja 24-25 vetë, por mësimet i kemi ndjekë rregullisht 17-18 vetë, ndërsa kom qenë edhe unë që i kom ndjekë mësimet rregullisht.

Në vitin e parë edhe në vitin e dytë i kom kry provimet por me nota të ulëta, nota ma e naltë e imja ka qenë tetë. Notat tjera kanë qenë... nji tetë-she e kom pas krejt, dy shtatë-she edhe katër gjashtë-she, kështu ka qenë niveli. Nuk ishte në pyetje veq gjuha, gjuha po se po, por ishte në pyetje edhe parapërgatitja. Me një fjalë na në vitin e parë kemi pas disa prej disciplinave të shkencave natyrore që unë në shkollë të mesme nuk i kisha kry në atë nivel. Kemi pas fizikë, optikë, akustikë, termodinamikë, provim te një profesor i njohur i Universitetit të Beogradit të fizikës. Me vështirësi shumë të madhe kom mbërrit ta zotëroj landën për një gjashtë-she. Kemi pas biologji- darvinizëm me vosht'rsi të madhe kam mbërrit t'i zotëroj këto landë. Kemi pas fiziologji, anatomi dhe fiziologji, sidomos anatomi e fiziologji të sistemit nervor edhe të sistemit endokrinolog, të gjandrave endokrine edhe të shqisave, të sistemit të shqisave. Po ashtu, edhe këtu kam pas vosht'rsi për ta zotëru si duhet këtë landë, ndërkaq prej landëve tjera kam pas nota më të larta. Bie fjala unë me këtë s'po du me u krenu, por prej paraushtarakut kom pas notë fort të lartë, mirëpo... a po din me udhëheqë pushkën, a po din me rregullu pushkën etj., etj., ato nuk ishin landë fort të vështira.

Prej histories, filozofisë, edhe pse kom pas dëshirë e kom bo përpjekje të jashtëzakonshme, kam kalu në afatin e parë të provimit por jo me notë ma tepër se sa gjashtë. Në logjikë kom pas notë shumë të lartë, kam pas nontë në logjikë, e nuk e di pse nuk ma kanë dhonë dhjetë. Nuk e kam të qartë as sot se e kam ditë ma mirë se sa që na pat shpjegu profesori, edhe sot e di logjikën mirë. Por pavarësisht prej kësaj, desha të tregoj se parapërgaditja e ime nuk ka qenë në nivelin e parapërgaditjes të kolegëve të mi që kanë qenë të regjistruar prej mjedisit të Beogradit, por edhe prej familjeve të njohura me traditë shkollore. Nuk ka qenë në atë nivel, ka qenë në nivel të ulët dhe deri sa ata bëjshin përpjekje të lehta për ta zotëruar landën edhe për të marrë notë të lartë, unë bëjsha përpjekje të shumta e me vosht'rsi të mëdha e merrsha një gjashtë ose një shtatë-she, kjo ka qenë.

Shkollimi im i mesëm pothuajse ka qenë shumë i shkurtër praktikisht, sepse para maturës, pesë muaj para maturës na kanë qitë në detyrë, kam qenë i detyruar me dalë mësues i shkollës filllore në fshatin e Deçanit, në shkollën filllore të Deçanit. Edhe aty kur kam shku në shkollë filllore të Deçanit me maturë kom qenë i detyruar të bëhem drejtore i paragjimnazit, i klasëve të paragjimnazit, dhe me dhonë mësim jo si mësues por si profesor në klasët e gjimnazit të ulët të asaj kohe, në klasën e parë edhe të dytë gjimnaz. Kom majtë unë landën e gjuhës shqipe, landën e historisë, landën e muzikës kurse këta tjerët i kanë mbajtë këto landët tjera. Menjëherë mas përfundimit të vitit shkollor, të vitit 1949, i jam nënshtrur provimeve të maturës të shkollës normale, të cilat provime i kam kry me sukses të shkëlqyeshëm, e kam edhe diplomën me të njëjtin sukses. E fal këtij suksesi, që osht' caktu, thashë edhe në fillim për t'a studiu pedagogjinë, por nuk kam pranu t'a studioj pedagogjinë, kam kërku ta studioj psikologjinë.

Duke mos ditur se do të kem vosht'rsi shumë të mëdha në zotërimin e atyre landëve për të cilat unë në shkollë të mesme nuk kom pas përgaditje të duhur, ju përmenda fizikën, ju përmenda anatominë dhe fiziologjinë, ju përmenda darvinizmin dhe evolucionin e biologjinë etj., etj., jeta ime për shkollim të mesëm osht' shumë e kufizuar, sepse të gjitha që i kom ndërmend gjatë kësaj kohe janë këto që i'u

thashë... me një shtesë të posaqme që kado që kom shku, kom pas mandolinë me veti. Muzikës nuk i'u kom nda, në fshat, në Deçan, në Irušniq, fshat krejt i lanun, me mandolin (buzëqeshë) kangë e poterë e gjurulldi që thotë mili<sup>4</sup> ynë e kam kalu shkollimin e mesëm, mirëpo njëkohësisht kom lexu shumë. Kom lexu shumë, bie fjala të gjitha librat ose romanet që i kemi pas në gjuhën shqipe të asaj kohe "Ana Karenina", fjala bjen "Nëna" e Maksim Gorkut.

Poetët e mëdhenjë të Italisë i kishte përkthyti në gjuhën shqipe Ernest Koliqi. Ata i kam njohtë fort mirë prej literaturës që depërtonte deri te ne, ne kemi pas përgjithësisht shqiptarë po edhe ne në Kosovë, po ata të Shqipërisë, ma tepër në pikëpamje të zhvillimit të arsimit dhe të kulturës, ata kanë qenë të lidhur më tepër me sistemin edukativ, arsimor, kulturor dhe shkencor të Italisë. Pjesa jonë, pjesa veriore si me thonë, na kemi qenë më tepër nën ndikimin e sistemit sllav, nën ndikimin e sistemit të Serbisë. Por gjatë kësaj kohe po flas përvitet e zhvillimit të Luftës së Dytë Botërore, sistemi i komunikimit të lirë më Itali ka depërtu bukur thellë edhe në Kosovë. Këtë pikëpamje [e gjen] në të gjitha romanet dhe në të gjitha përkthimet që janë kry kanë qenë përkthime të shqiptarëve që kanë jetu dhe janë shkollu në Itali, e që njëkohësisht kanë përkthyti prej italishtes në gjuhën shqipe.

Po ashtu gjatë kësaj kohe edhe shkrimtarët shqiptarë, aq sa kanë qenë, Naim Frashëri, Sami Frashëri, Ndre Mjeda, Ernest Koliqi, Migjeni etj., etj., gjatë kësaj kohe kanë depërtu në Kosovë, më parë nuk i kemi pas. Për Migjenin, unë kom dëgju tek kur kam mbrri në klasën e katërt gjimnaz. Në Shqipëri kanë dëgju shumë më herët, ose për romanin "Nana" të Dea Nicës, kom dëgju shumë vonë, ai romani ka qenë i përpunum në Itali, nxanësit e shkollës filllore e kanë ditë. Unë përvete e kam lexu gati kur kam qenë adoleshent, sepse nuk kemi pas ne mundësi të kontaktojmë me literaturë të jashtme.

Të gjitha këto nuk kanë qenë pa ndikime esenciale në zhvillimin e personalitetit edhe të tipareve të personalitetit tim. Andaj këto tipare të personalitetit tim, mendoj se edukata familjare që ka qenë relativisht e përquar me sistemin fetar, edhe kjo ka qenë e repte, bie fjala gjatë kohës së fëmijërisë edhe të rinasë. Këndonte hoxha akshamin dikush prej familjes ishte i detyruar me i'a vendosë kunjin derës dhe me mylli me çelës derën, komunikimi me botën e jashtme ndërprijet, deri të nesërmëni në mëngjes, kështu ka qenë në atë kohë. (Qeshë) Sot osht' ndryshtë, por me i'u tregu fëmijëve të mi... kur i'u tregoj këto janë të pabesueshme.

Kom marrë pjesë si fmi, me prindërit e mi edhe në kohën e zhvillimit të lutjeve fetare në xhami, në teqe. Kom shku si vëzhgues edhe në kishë me shokët e mi katolikë. E përvjetori të madhe unë shoqërinë më të ngushtë edhe në fëmijëri, edhe në rini, edhe tash e kam me katolikë. Nuk di prej nga ka ardhë kjo, por po shpjegoj që kam qenë në kontakte të vazhdueshme me ta edhe prej natyrës marrëse ...ky kontakt ka shkaktuar edhe afërsi dhe dashuri më të madhe ndaj tyre. Unë bie fjala këtu kam tash shok të ngushtë Engjëll Berishën, muzikant osht', ai osht' i fesë katolike. Jom njohtë me të qysh ndoshta prej shkollës

---

<sup>4</sup> Turq.: populli, kombi.

normale. Kumbari i vajzës sime, që i'a ka pre flokët vajzës, ka qenë Mark Kaqinari katolik, kam mund me i gjetë një qind a nji mijë myslimanë, por unë kom pas besim te njeriu me tipare të posaçme njerëzore jo me tipare fetare.

Prandaj mendoj se ky mqedisi ynë me t'vërtetë osht' karakteristik për solidaritet edhe për një tolerancë fetare që nuk osht' e pranishme në mqedise tjera në këtë nivel qysh osht' i pranishëm edhe te unë. Unë bie fjala po marr pjesë në një konferencë për pajtim gjaqesh në Tiranë, kur po vjen e po më thotë një i ri, "Unë jam i familjes sate se edhe unë e kam mbiemrin Nushi". "Prej nga je ti?" "Prej Mirditës". "Si e ka emrin baba yt?" "Nikollë". Katolik! Mirëpo n'afërsi familjare pse e ka edhe ai mbiemrin Nushi edhe unë mbiemrin Nushi. Po nga ana tjetër edhe kom pas ka pak telashe ma vonë kur kam qenë në jetën politike rrith viteve '60- '70-ta kur ishin ndërprerë raportet keq me Shqipërinë. Atje ka pas funksionar të lartë politik me mbiemrin Nushi. Ka qenë presidenti i presidiumit të parlamentit shqiptar me mbiemrin Nushi, katolik. Unë se kam njoftë as atëherë as tash, ai ka vdekë, as ai mu as unë atë. Mirëpo, këtu kérkojshin çfarë raporti familjar kom me këtë njeri. Ka qenë një prej diplomatëve të njojur, në sistemin e shtetit të Enver Hoxhës me mbiemrin Nushi, ai ka qenë ortodoks i jugut të Shqipërisë. Kurrë s'e kom pa, as ai kurrë s'më ka pa, mirëpo këtu kérkojshin çfarë lidhje, çfarë rrënjoshtë kam unë me këtë njeri që ish diplomat i njojur, e unë po përsëris as tash nuk e kam njojur. Kam pyet më kanë thënë "Ka vdekë moti".

Me fjalë të tjera edhe më ka shërby ky mbiemër (qeshë) për anë positive ma tepër por kaj'herë edhe për anë negative, por nuk më ka shkaktu noj dom. Unë nuk kom ndi' kurrë nevojë ta ndërroj mbiemrin, jo vetëm aq, por edhe bashkëshortja e ime mbiemrin e vajzërisë e ka Nushi, bashkëshortja ime {drejton gishtin nga vetja}, sepse nuk kemi lidhje familjare e farefisnore me të. Qysh ju thash unë mbiemri i vërtet i familjes sime paska qenë Shyti jo Nushi, kurse mbiemri i vërtetë Nushi, mbiemri original osht' i axhës së shoqes sime [gruas], kështu që ajo nuk ka pas nevojë me ndërru mbiemrin, as unë me ndërru mbiemrin, kemi të njëjtin mbiemër. (Qeshë)

**Anita Prapashtica:** Na tregoni diçka për familjen.

**Pajazit Nushi:** Po. Familja, para lindjes sime kuptohet, paska qenë familje e madhe edhe familje duket relativisht e pasur. Baba im, ose ma mirë me thanë babës sim në rini i pamartum, ja paskan pas kthy në atë kohë njëren prej grave të vllaut të vetë që ka vdekë. Ka vdekë, edhe ajo grua sipas zakonit të asaj kohe, i osht' kthy babës sim. Por ajo ka ardhë në shpi të babës sim edhe me një Xheladin Nushin, nuk e njoh, unë u mor vesh s'kom qenë as i lindur në atë kohë, i cili paska qenë shkollu, ka vazhdu studimet. Janë nda njëherë edhe janë vendos në Tiranë, kjo e Xheladin Nushit. Kom fitu përshtypjen se jonë nda për arsyetë mospajtimit qysh nana e tij, e ky i rritun, të martohet me babën tim. Kom përshtypje, por nuk i di ato kohëra s'i kom përjetu. Prej nanës sime kom dëgju se mund të jetë një prej shkaqeve që ata janë nda, janë vendosë në Tiranë.

Ai ka vazhdu studimet, paska kry në Grac fakultetin e ekonomisë, menjëherë osht' doktoru në shkenca ekonomike. Osht' kthy si këshilltar në oborrin mbretëror të Ahmet Zogut. Në ndërkokë osht' martu me një

qytetare prej Vjenës. Osht' ardhë ajo në Tiranë, ka zhvillu mësim në shkollën e "Nanës mretneshë" [Nënës mbretëreshë] të asaj kohe. Kështu paska pas qenë quajtë ajo shkolla "Nanës mretneshë", shkollë e njohur përndryshe, ma vonë kom dëgju për këtë shkollë. Kanë lindë një fëmi një vajzë, ajo osht' ende gjallë, emrin e ka pas Shpresa.

Por në ndërkohë për arsy se osht' detyru t'ikë prej regjimit të Enver Hoxhës, e ama [ëma] bashkë me këtë në Vienë tek sa ka qenë e lindur, kanë ndrru emrin edhe mbiemrin për me mujtë me siguru jetën në Vjenë. Në këtë pikëpamje ajo... Emri i saj sot osht' një emër Italian e ka qe besa por më ka ikë prej kujtesës. Emri i vërtetë edhe ajo vetë e thotë jam Shpresa, por mbiemri i saj kuptohet me martesë ka qenë e detyrume edhe ta ndërrojë mbiemrin. Unë e kam kérku gjatë kohës, gjatë viteve '70-ta në Vjenë, me ndërmjetësi të ambasadës Jugosllave, por e kam kérku me mbiemrin Nushi, Shpresa Nushi. M'kanë thonë ambasada jugosllave gjatë kohës kur kom qenë me delegacionin jugosllv në një mbledhje të UNESCO-s në Vjenë njo nji javë ditë, "Familje Nushi në Vjenë nuk ka".

Unë kam hekë dorë prej asaj kohe. Papritmas në shtëpi një ditë, po më duket në vitin 1999, një shok i imi prej Vjenës m'ka lajmëru në telefon. "More" thotë, "këtu kom një gru që quhet Shpresa Nushi, po thotë se e ka emrin Shpresa e mbiemnin Nushi. E po dëshiron me ditë çfarë Nushi je ti, i cilit Nush je ti, i cilit Nush osht' ajo". "Po bre" po i thomë, "unë e njohë atë ajo nuk më njehë mua, ajo osht' e familjes sonë". I kom tregu origjinën e vetë jemi lidhë me te dhe tash vazhdojmë disa herë ka qenë të unë, para nja tre-katër muajve ka qenë për vizitë herën e fundit. Komunikojmë me të normalisht, jo për çdo mbrëmje por ndoshta një herë në javë po me anë të emailave më anë të telefonave etj., etj.

Ajo ka dy vajza e një djalë, osht' bo natyrisht gjyshe, osht' në moshë të pleqërisë. Profesoreshë e anglishtes në Universitetin e Vjenës ka qenë, osht' pensionu në këtë Universitet. Dhe në këtë pikëpamje unë edhe kom pas pengesa politike këtu. Nuk kam guxu të i'a përmendi emrin Xheladin Nushit këtu. Nuk kam guxu për arsy se ka qenë, ose kish qenë zogist edhe i përbetuar anti komunist. I ka njekë komunistët e ka njekë Fadil Hoxhën dhe Xhavit Nimanin udhëheqës të lartë të Partisë Komuniste në Kosovë. Sa ka qenë nxanës i normales, I kane hekë veç pse kanë qenë komunista. Edhe këta këtu, Fadil Hoxha osht' përpjekë t'informohet, çfarë e kom pas unë Xheladin Nushin, dhe i kam tregu se unë s'e kom pas kurgjo, nuk e njoh nuk kam pas kurfar lidhje familjare. Thotë, "I vetmi njeri që neve na ka njekë, ka qenë Xheladin Nushi". Edhe kjo vajza e tij më ka thanë se ka ba çmos Enver Hoxha, edhe natyrisht njerëzit e tij ta kthejnë këtë, Xheladin Nushin prej oborrit mbretëror ta fusin në Tiranë. Mirëpo ky i osht' përgjigjë Enver Hoxhës, "Derisa ju keni lidhje me sovjetikët kamba e ime ma në Shqipëri nuk shkel!" Nuk osht' kthy në Tiranë se përndryshe të gjithë ata që jonë kthy ata jonë pushkatu, jonë vra etj., etj. Por edhe ky nuk ka pas fat të mirë me oborrin mbretëror, m'duket se osht' fjalos jonë përplas me oborrin mbretëror në Londër.

Oborri mbretëror, pesë vajzat e Ahmet Zogut, Ahmet Zogu me fëmijët e vetë me familje të vetë me përcjellje të vetë, prej Londrës ka kalu në Kajro në Egjipt, ky nuk ka pranu të shkoj në Egjipt ka ngelë në Londër. Ka vdekë papritmas prej sulmit n'zemër, edhe fjalën për mortore e ka majtë njëri prej intelektualëve të njohur të asaj kohe, shqiptar. M'ka thonë vajza e vet, se në atë gurin e varrit të tij shkrunk

përafërsisht "I lumtur osht' ai që vdes i ndershëm si Xheladin Nushi" në një anë shqip e në anën tjetër anglisht. Kom gjurmua për këtë, kam shkru për këtë, kom mbledhë material për këtë njeri. Kom pa se ka qenë njeri i dukshëm, kam pa se ka qenë edhe njeri i zgjut'.

E kam dallu edhe unë se ka qenë anti komunist, kam dallu edhe unë se ka qenë zogist i madh, bindje shumë të madhe në Zogun. Mirëpo për çudi shumë të madhe, në përpjekjet e mia për me gjetë materiale drejtpërdrejtë prej oborrit mbretëror edhe prej bisedës që kom pas me Lekën me këtë që vdiç, të birin e Ahmet Zogut, edhe me këta të tjerët nuk pranojnë me dhonë kurrëfar informacionesh drejtpërdrejtë. Këto informacione që i kom, i kom prej shokëve të vetë ose prej leximeve të ndryshme ose prej dokumenteve të ndryshme.

E duket se përplasjet mes tij edhe të oborrit mbretëror, kanë qenë të fuqishme në Londër sa që këta... më osht' premtu që kur të vjen arkiva prej Afrikës se Jugut e Ahmet Zogut, mund të gjinden dokumente. Por, nuk besoj që edhe i jepin ato dokumente, a unë jam në gjurmim të të gjitha dokumenteve që mund ta njohë sa më hollësish, du me qitë n'dritë personalitetin e tij. Personalitetin qashtu qysh shkruajnë dokumentat, jo ashtu qysh kom dëshirë unë. Se unë kurrëfar kontakti, as edhe sikur të kisha deshtë s'kisha mujtë me pas me te, nuk kom pas kontakt më të, kjo osht' ajo që...

Unë sikurse osht' e ditur, kur kam qenë i përcaktum për studime të psikologjisë, dhe këtë degë, degën e psikologjisë e kom kry në katedrën e atëherëshme të Universitetit Filozofik të Beogradit, prej vitit 1950 deri në vitin 1954, kështu që profesioni im i ngushtë osht' profesor i psikologjisë. Deri në përcaktim të këtij profesioni nuk kom ardhë rastësish, por qysh prej shkollimit të mesëm kom tregu njëfar interesimi të posaçëm për gjurmimet e dukurive shpirtërore të njeriut, sikurse edhe për mundësinë e njohjes së proceseve psiqike edhe të sjelljeve të njeriut përgjithësisht.

Duke supozuar se me këtë njohje mund të organizohet një aktivitet i vyshëm për zhvillim të mjedisit të Kosovës në atë kohë. Ajo kohë ka qenë fillimi i viteve të gjysmës së dytë të shekullit XX, kohë kur Kosova ballafaqohej sa me zhdukjen e analfabetizmit, aq edhe me nevojën për hapjen e rrjetit shkollor të shkollimit fillor, të shkollimit të mesëm. Atëherë nuk kemi pas ndonjë koncept për shkollim të lartë e shkollim universitar në Kosovë, ky koncept ka lindë ma vonë.

Pas përfundimit të studimeve unë kam kry shërbimin ushtarak në ish armatën jugosllave. Kom qenë ushtar i thjeshtë në njësinë artilerike të ish armatës jugosllave, kom kry me një rezultat të dallueshëm këtë shërbim, kom pas falenderime të posaçme. Nuk posedoj kurrëfar grade ushtarake. Kështu që pas shërbimit ushtarak më nuk kam pas rast të inkuadrohem në ndonjë njësi mbrojtëse, njësi ushtarake, njësi civile mbrojtëse etj., etj. Në përfundim të shërbimit ushtarak, me fjalë të tjera kom këputë definitivisht angazhimin tim në mbrojtje civile apo në mbrojtje ushtarake etj., etj.

Profesionin tim e kam nisë si profesor i psikologjisë, në ish-gjimnazin e Gjakovës, por unë jam afirmu si psikolog i psikologjisë në shkollën normale të atëhershme, ku psikologjia ka qenë landë dominuese ndër landët më të rëndësishme për formimin e profilit t'duhun të mësuesit, përkatesisht të arsimtarit. Kom

punu pesë vite në shkollën normale të Prizrenit, në shkollën normale e quajtur në atë kohë "Dimitrie Tucoviç", për të kaluar ma vonë në shkollën normale "Milladin Popoviç" në Prishtinë, në t'cilën shkollë kom kaluar pesë vite të tëra. Dy vite të fundit kom qenë edhe zavendës drejtori i shkollës normale "Milladin Popoviç".

Prej këtij funksioni jom zgjedhur si drejtor i Entit të Kosovës për Përparimin e Shkollave. Këtë funksion e kom kry jo plot dy vite sepse kom qenë i propozuar prej Kosovës, dhe kom qenë i zgjedhur nga ana e Këshillit Ekzekutiv Federativ të ish Jugosllavisë si ndihmës i kryetarit për arsim dhe kulturë i Federatës Jugosllave, që me përkthy në gjuhën tonë të sotme do të thotë ndihmës ministri i arsimit dhe i kulturës për Jugosllavi. Këtu kom kry një mandat aq sa na ka taku, e ai mandat ka qenë disa muaj ma tepër se katër vite. Shërbimi ka qenë kuptohet në kuadrin e jetës sime në Beograd, kom pas me veti edhe familjen time, fëmijët, bashkëshorten dhe nanën time në Beograd. Kështu që, Beogradi për mu, duke përfshirë vitet e studimeve edhe vitet e punës aktive, shënon gati një të katërtën e jetës sime që kom kalu në mjedisin e Beogradit. Kam pasë shokë shumë, kryesisht nga rrëthi profesional, por mund të them se ai rrëth shokësh dhe shoqesh kanë qenë shumë seriozë, dhe asnjëherë në këtë mjedis ku unë jom sjellë nuk e kom ndi veten inferior sepse rrëthi nuk më ka dhënë rast që ta ndij veten të këtillë.

Kom pas një sukses relativisht të mirë në punën time. Unë gjithmonë kam marr falënderime në aktivitetin tim professional dhe në atë që kom kry më së tepërmë në funksionin e nënkyetarit të këshillit për arsim e kulturë të Jugosllavis osht' angazhimi im profesional në transformimin e shkollimit fillor në Jugosllavi. Deri atëherë shkollimi fillor ka qenë i parcializuar sipas republikave, ka zgjatë dikund katër vjet, dikund gjashtë vjet, dikund pesë vjet, kurse pas themelimit të konceptit kryesor për shkollimin fillor në nivelin jugosllav shkollimi fillor osht' caktuar që të bëhet tetë vjeçar. Dhe ka qenë standard i përbashkët përvendet e zhvilluara në Jugosllavi, fjalën e kom për Slloveni e Kroaci, që kanë qenë shumë përpara Kosovës, qoftë për Kosovë që ka qenë shumë prapa zhvillimit ekonomik, politik, social e kulturor. Shkollimi fillor i detyrueshëm për sistemin e atëherëshëm arsimor të Jugosllavis ka qenë shkollim 8 vjeçar. Pas shkollimit 8 vjeçar, gjeneratat qe e kryenin me sukses shkollimin fillor vazhdonin mësimet në shkollat e ndryshme të nivelit të mesëm. Interesimi ma i madh ka qenë kuptohet për gjimnaze, edhe ma pak i afirmuar ka qenë interesimi për shkolla profesionale të ndryshme të tipeve të ndryshme, bie fjalë, për shkolla profesionale të profesioneve teknike, të profesioneve mjekësore, Dallim në këtë pikëpamje kanë pas shkollat artistike, sepse aty janë pranu dhe kanë viju studimet, përkatësisht mësimet nga ana e atyre nxënësve që kanë pas prirje, qoftë për muzikë qoftë për skulpturë ose pikture etj., etj.

Po ashtu, mund të them edhe për disa shkolla profesionale të ngushta kemi pas në atë kohë bie fjalë gjimnazi matematikor, këtë e kemi pas organizu edhe në Kosovë, për ta që kishin talent, kishin prirje për matematikë. Edhe mendoj se ato pak gjenerata që kanë dal prej këtij gjimnazi, kanë qenë matematikanë të afirmuar më vonë, u zunë vendin e profesorëve në fakultete të ndryshme dhe në institucionë ku kërkohet njohje e lartë e sistemit matematikor. Unë në të njëjtën kohë kur kam qenë drejtor i Entit për Përparimin e Shkollave, jam pranu edhe si ligjërues i psikologjisë në shkollën e lartë pedagogjike në

Prishtinë. Aty ma kanë ba të mundësishme, që orët e mësimit t'i mbajt Jashtë sistemit të rregullt të shkollës. Me fjalë të tjera, unë këto orë të mësimit i kam mbajt Jashtë tetë orëve të punës që i kam kry në zyrë.

Ma vonë kam qenë i pranuar edhe si ligjërues i psikologjisë, në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Nuk jam nda prej profesionit tim si profesor i psikologjisë, qoftë në Shkollën e Lartë, qoftë në fakultet edhe atëherë kur kam punu në Beograd, edhe atëherë kur kom punu në organe administrative qysh ka qenë këshilli ekzekutiv i Kosovës, qysh ka qenë këshilli ekzekutiv federativ i Jugosllavisë. Prej Beogradit kom udhëtu çdo javë për të mbajtë mësim nga psikologjia, ditëve të shtuna dhe ditëve të diela, përkatësisht ditëve të vikendit që ishin ditë pushimi për ne.

Kjo më ka ndihmu shumë, sepse ma vonë kom qenë i detyruar që të largohem prej organeve politike ngase në vitin 1981, kur isha nënkyretar i këshillit ekzekutiv të Kosovës përkatësisht nënkyretar i ekzekutivit të Kosovës, pëlcitën demonstrata të studentëve në Kosovës. Të cilat demonstrata... u përpoqa në një mbledhje të zgjeruar të komitetit të Lidhjes së Komunistëve të Kosovës t'i mbroj ata që kishin marrë pjesë në demonstrata me disa argumente të cilët i luta që t'i kenë parasysh ata kur t'a vlerësojnë karakterin e këtyre demonstratave. Por jo vetëm që nuk gjeta përkrahje, nga ana e tyre që më njihshin mirë, por pjesa dérrmuese e tyre, më kritikan ashpër dhe më sulmuan ashpër dhe më detyruan që të japi dorëheqje prej funksionit të nënkyretarit të ekzekutivit të Kosovës.

Shkaku kryesor që nuk më morën në konsideratë ata që nuk më përkrahën, ishte se unë në këshillin ekzekutiv kom qenë përgjegjës jo vetëm për zgjerim të arsimit, kulturës, shkencës, të kulturës fizike, të shëndetësisë në Kosovë. Por në fushëveprimin tim ka qenë edhe aktiviteti i marrëdhënieve ndërkombëtare të Kosovës me vendet tjera, e konkretisht ne në atë kohë kemi pas marrëdhënie ndërkombëtare kryesish me Shqipërinë me republikën e Shqipërisë, të cilat marrëdhënie kanë qenë të definuara me anën e dokumenteve të posaçme ndërmjet institucioneve por jo ndërmjet qeverive.

Kemi pas protokol bashkpunimi bie fjala në mes Universitetit të Prishtinës dhe Universitetit Shtetëror të Tiranës i cili përtrihej për çdo dy vite. Kemi pas protokoll bashkpunimi në mes Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, që përtrihej me sa më kujtohet pas çdo dy vitesh. Por përpos këtyre, protokole bashkpunimi kanë pas edhe institucionet tjera kulturore dhe e informative, bie fjala Teatri Kombëtar... Teatri Krahinor i Prishtinës ka pas bashkpunim edhe me Teatrin e Tiranës, Teatrin Kombëtar të Shqipërisë. Televizioni i Prishtinës ka pas bashkpunim me televizionin e Tiranës, të gjitha këto ose për të gjitha këto kemi qenë përgjegjës ne, këshilli ekzekutiv. E i pari që ka qenë përgjegjës për këtë kam qenë unë, sepse në fushëveprimin tim sikurse i'u thashë ka qenë edhe kjo çështje.

Unë pas të gjitha turbullirave të mëdha që pësoi Kosova në atë kohë, edhe pas informacioneve jo korakte, për mos me thonë informacioneve të trilluara që ka pas, edhe të trilluara, kom mbajtë njëfar dënim i që përafërsisht mund të quhet edhe burg shtëpiak. Më kanë thanë që mirë osht', udhëheqësia e

Kosovës e asaj kohe, kryetari i kryesisë së Kosovës, mirë osht' mos me dalë edhe kur del, mundësish me dalë natën. Madje, edhe në universitet nuk ma kanë ndërpren punën, por m'kanë vu kusht që të mbaj mësim vetëm natën. Kështu që orët e mësimit, orët e ushtrimeve, gjurmimet e mia empirike i kom organizu në orët e vonshme të netëve të viteve të turbullta të fillimeve të '80-ta, '90-ta. Prej psikologjisë, me fjalë të tjera prej profesionit tim këtë duhet t'a theksoj nuk jam tërhjekë kurrë. Kom shkru punime shkencore, trajtesa shkencore, artikuj, kritika, recensione, por kryesish ato që janë marrë me çështjet psikologjike. Kom pas edhe funksione tjera, bie fjala një prej funksioneve që kam qenë ma tepër i goditur pas vitit 1981, ka qenë organizimi i një qind vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Unë kom qenë kryetar i këshillit organizues të këtij këshilli. Ne mendoj se e kemi shënu një qind vjetorin në Kosovën e atëherëshme me një program mjaft të pasur. Ky program i pasur ka përfshi Konferencën Ndërkombëtare për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, që e kemi pas organizuar një javë këtu në Prishtinë. Ka përfshi, hapjen e Qendrës Memoriale të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, osht' edhe sot, e ajo daton prej kësaj kohe. Në kuadrin e kësaj qendre kemi pas hapur skulpturat e prijësve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, qysh ka qenë në rend të parë Abdyl Frashëri, qysh ka qenë kryetari i parë i qeverisë së atëherëshme të Lidhjes së Prizrenit, sikurse edhe ministri i asaj kohës i Mbrojtjes dhe i Financave, Sylejman Vokshi.

Kanë marrë... patën marrë përpjestime të mëdha gjurmimet dhe informimet e gjera për rolin e Lidhjes Shqiptare edhe në shtypin e përditshëm të Kosovës, edhe në revista të Kosovës. Ato vite kanë qenë vite ku ka dominu Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Ajo për ata që nuk e dijnë ka qenë e drejtuar në dëbimin e pushtuesit osman dhe mbrojtjen e kufinjëve të etnisë shqiptare. Mbrojtja e kufinjëve të etnisë shqiptare, nuk ishte në përputhje me dokumentet që kishin udhëheqësia e Serbisë e asaj kohe në rend të parë, por jo vetëm e Serbisë edhe e Maqedonisë, edhe e Malit të Zi. Për këtë arsy, u gjetën në një të them kurth të pashpjegueshm. Edhe për mendimet e sotme që unë isha në atë kohë neutral, qëllimi im ishte ta paraqes të vërtetën për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, ajo e vërtet i ka taku vitit 1878 por jo vitit 1978, por pala tjetër e trajtimit të kësaj çështjeje, komisionet e ndryshme ideologjike të Komitetit Krahinor të Kosovës, të Komitetit Qendorr të Serbisë, të Malit të Zi, të Maqedonisë, u gjetën të ofenduar nga këto programet tonë të trajtimit të këtillë të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, dhe e goditën edhe Lidhjen Shqiptare edhe udhëheqësit. Por praktikisht atyre udhëheqësve nuk kishin çfarë t'u bënin por u vërsulën në mu, dhe prej asaj kohe unë kom qenë i nominuar si armik politik i asaj kohe. Këtë e kam hetu në ato situata kur m'kanë thonë, "Mirë osht' që të mos lëvizësh prej shtëpisë dhe të dilësh vetëm kur të kesh nevojë natën."

Në këtë pikëpamje, mund të them se kom përjetu një tronditje relativisht të fuqishme. Edhe sot jom i bindur për ta tregu një të vërtetë, të vërtetë historike që më ka taku mu, sepse isha njeri i shkencës, e shkenca nuk di me marrë parasysh a i pëlqen dikujt a nuk i pëlqen një gjë. Ajo e di osht' e vërtetë, a nuk osht' e vërtetë kjo, por pasojat e këtij linçimi ta quaj, kanë qenë të ronda, jo veç për mu, por edhe për familjen time. Na janë këputë bie fjala, m'osht' këputë e drejta me marr rrogë, me marr page. Merrsha diç

prej orëve të pakta prej tri orëve mësim që kisha në Fakultetin Filozofik. Madje burime tjera të të ardhurave nuk kisha. Kështu që në këtë pikëpamje kam pas një debakël bukur të keq.

Unë nuk kom qenë i inkuadruar në Partinë Komuniste me dëshirën time. Jam inkuadruar në Partinë Komuniste në vitin 1955, kur i kam qit dokumentet e para për t'u punësu për me hy në punë, m'osht' kërku edhe dokumenti që jam anëtar i Partisë Komuniste. Atëherë kom pranu të bëhem anëtar i Partisë Komuniste. E kom marrë edhe vërtetimin i'a kom bashkangjité dosjes së dokumenteve tjera, diplomës së fakultetit etj., etj. E tek atëherë, kom fitu të drejtën me qenë profesor i shkollës së mesme, në shkollat e mesme të Kosovës, gjegjësisht Gjakovë, Prizren, Prishtinë. Mirëpo në ndërkohë, kom qenë përkrahës i konceptimeve për zhvillimin e kulturës dhe të arsimit edhe të shkencës ndër shqiptarët e Jugosllavisë së atëherëshme. Nuk ma ka imponu këtë kërkush, por unë vetë e kom përkrahë koncepcionin që e kanë dhanë udhëheqësia e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë në atë kohë. Dhe kom qenë një prej të angazhuarve për realizim të të drejtës së shqiptarëve për histori të tyre, për gjuhë të tyre, për kulturë të tyre, për zhvillim ekonomik të tyre etj., etj.

Në organe të Lidhjes Komuniste unë nuk kom qenë asnjëherë i angazhuar, kjo osht' me randësi të theksohet. Por gjithmonë organet e Lidhjes Komuniste të Kosovës më kanë ftu në konsultime edhe në konsultime të randësishme për ngjarje arsimore, kulturore dhe shkencore në Kosovë. Nuk kom qenë i angazhuar, nuk i di as vetë shkaqet, por kjo nuk më ka pengu mua aspak.

Ma vonë kam dëgju se një vëlla i babës sim që ka jetu dhe osht' i njohur në Shqipëri si anëtar i kabinetit të Ahmet Zogut, ka qenë zogist i përbetuar dhe i paska pas përndjekë rreptësish komunistët e asaj kohe ndër të cilët edhe Fadil Hoxhën edhe Xhavit Nimanin edhe Elhami Nimanin edhe Imer Pulën etj., etj. Unë atë nuk e kom njohtë kurrëherë sepse ai jo vetëm që ka qenë i ndarë prej familjes sonë, por ai ka qenë shumë më i vjetër se sa unë, kështu që unë nuk e kam mbërrit atë kohë. Por prindërit e mi e kanë adhuru mbretërinë e Zogut, mbretërinë shqiptare. Nuk kanë qenë të angazhuar në lëvizjen komuniste, jo se e kanë refuzuar se nuk kanë pas ndonjë angazhim të posaçëm, por osht' e vërtetë se më përpara e kanë dashtç Ahmet Zogun se sa Josip Broz Titon; ma përpara Ahmet Zogun, sesa Fadil Hoxhën.

Mendoj që ka ndiku kjo njohje se këta jonë interesu ka e kom unë origjinën, kjo pjesa e ktyne që kanë qenë të përndjekur në atë kohë në Shqipëri dhe kanë qenë se unë i takoj kësaj familje etj., etj. Dhe mendoj se ky ka qenë shkaku që në mbledhje shumë të rëndësishme të nivelit të Kosovës por edhe të nivelit të Jugosllavisë, të Lidhjes së Komunistëve, unë kam qenë i pranishëm pa të drejtë vote. Kom diskutu i lire, në mënyrë që të kenë parasysh ata që vendosin edhe faktet argumentet për të cilat unë kom diskutu. Kom qenë i angazhum në të ashtuquajturin e asaj kohe në Organizatën e Lidhjes Socialiste të Popullit Punues. Përpara osht' quajt' Fronti Popullor, në të cilën kemi qenë të gjithë qytetarët e moshës së rritur pjestarë, edhe unë kom qenë aty në nivel të krahinës. Por, kjo ka qenë organizatë, nuk di si të them, organizatë masovike popullore, shumë e ngajshme me sindikatat e atëherëshme dhe sindikatat e sotme.

Pavarësishët prej gjithë kësaj nuk kom pas pengesa në botim të trajtesave të mia, nuk kam pas pengesa në botim të librave të mi. E unë derisa nuk kom dhënë dorëheqje, kom qenë i dënuar nga një komision i posaçëm i Lidhjes së Komunistëve të Komitetit Krahinor të asaj kohe me para përjashtim prej Lidhjes Komuniste. Mirëpo me zhvillimet e mavonshme sidomos me zhvillimet politike të ardhjes së Millosheviqit, unë kom dhonë dorëheqje prej Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë. Dorëheqja e ime ka shku edhe me shkrim lagjes sime, organizatës së lagjës ku kom marrë pjesë si anëtar i asaj njësie.

Kom botuar në revista jo veq të Kosovës por edhe në revista të ish republikave të Federatës Jugosllave. Disa prej trajtimeve më janë botu edhe në gjuhë të huaja. Kom marrë pjesë në shumë simpoziume, tryze, konferanca shkencore në Jugosllavi edhe jashtë Jugosllavisë. Por në ato tryze dhe në ato tubime shkencore, që kanë pas të bajnë me zhvillim të arsimit edhe me zhvillim të psikologjisë, edhe të raportit të psikologjisë në shërbim të zhvillimit të shkollave dhe në favor të organizimit të mirë të procesit mësimor. Në këtë pikëpamje bie fjala, kom qenë edhe në Lublanë, osht' quajtë njëfar institucioni përvjetor i asaj kohe, Universiteti Danas. Në Dubrovnik kom mbajtë kumtesa, Hercegnovi. Kom qenë anëtar i delegacionit jugosllav në konferencën për UNESCO në Zhenevë. Kom qenë anëtar i një delegacioni të posaçëm për hulumtim të përdorimit të televizionit edukativ në procesin mësimor në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku i kam kalu nga tre muaj. Po ashtu...

**Anita Prapashtica:** Kjo ishte profesor, kur në cilat vite?

**Pajazit Nushi:** Jo, kjo osht' shumë ma vonë. Kjo për të cilën po flas unë tash për SHBA-të, ka qenë kur kam qenë në Beograd në vitin 1973-74. A ma vonë prej Kosovës në vitin 1978 kom qenë si anëtar edhe udhëheqës i delegacionit jugosllav për një vizitë studimore në Republikën e Kinës, ku kemi kalu nga tri javë në shëtitje të institucioneve kulturore, arsimore dhe shkencore. Në Shangai dhe në vende tjetra të Republikës së atëherëshme të Kinës, përkatësisht në qendrën e Kinës në Pekin, prej andej kemi shku sipas programit të vizitës studimore në universitete të ndryshme, biblioteka të ndryshme. Kemi pasë pritje të nivelit shumë të lartë nga ana e udhëheqësisë kineze të asaj kohe, sepse Jugosllavia e asaj kohe gjëzonte njëfar autoriteti relativisht të fuqishëm në qarqet e vendeve të ndryshme po ashtu edhe në qarqet e Azisë duke përfshirë edhe Kinën, e sidomos duke përfshirë Korenë e Jugut. Por me sa di edhe Korea Veriore, Korea komuniste që quhet sot ka qenë... ka pas raporte të mira me ish-Jugosllavinë. Kështu që delegacioni që e kom udhëheqë unë, ka qenë delegacion pothuajse prej të gjitha republikave dhe Vojvodinës, krahinës tjetër. Patëm kalu një rrugë vëzhguese shumë të rëndësishme, këtë e përmendi vetëm për arsyë të besimit që mu ka pas dhënë në atë kohë që të jem udhëheqës i një delegacioni të nivelit Jugosllav në një shtet shumë të njojur qysh ka qenë republika e Kinës.

Në atë kohë, fjala osht' për vitet 1977-'78, nuk janë hetu së paku ndaj meje dallime të posaqme që jam shqiptar edhe unë ndaj meje. Serbi, malazezi, maqedonasi, kroati, slloveni ka qëndrime të rezervuara? Përkundrazi në ato qarqe ato kanë qenë shumë të kufizuara ku unë jam sjellë. Ata kanë qenë njerëz me përmasa të dallueshme humanitare, për këtë arsyë mund të shpreh një falëndërim, si me thënë për ato sjellje të atëherëshme sikurse që mund të them, shumë fjalë negative për sjelljen e të njëjtëve njerëz kur

unë kom dhënë dorëheqje prej funksioneve politike në Kosovë. Të njëjtët njerëz në nivelin e Kosovës, shqiptarë por sidomos serbë, edhe në nivelin e Jugosllavisë edhe në nivelin e republikave të tjera më kanë akuzu pa të drejtë, për lejimin e bashkëpunimit të institucioneve tona kulturore, arsimore, shkencore, informative me institucionet përkatëse të Republikës së Shqipërisë. Nga ana tjetër unë jam vu në mbrojtje të një faktori tjetër, unë i kom shpjegu demostratat e atëherëshme si kundërthanje që kemi pas ne në Kosovë për arsyen zhvillimit të ulët ekonomik, të zhvillimit të ulët social etj., etj. Edhe që, nuk kanë qenë shkaktarë të këtyre demostratave në Kosovë, profesorët e universitetit shtetëror të Tiranës që kanë ardhë një herë, një javë brenda një muaji. Ata nuk mund të jenë shkaktarë, këtë qëndrim e kom majt' gjithmonë e maj edhe sot. Mirëpo megjithatë nuk kam pas preperkursione politike të rënda, qysh kanë pas disa prej shokëve të mi.

Unë, si njeri i angazhuar dhe i interesuar për zhvillim të kombit tim në rend të pare, nuk e kom pa të arsyeshme që të inkuadrohem në parti politike kur sistemi i Kosovës kaloi në sistemin shumëpartiak. Nuk e kom pa të arsyeshme që po rri 34 vjet e pesë muaj duke paguar anëtarësi në Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë, e tash po bëhem anëtar i Partisë Socialdemokrate të Kosovës, anëtar i Partisë Demokratike [Lidhjes Demokratike] të Ibrahim Rugovës, anëtar i parties... t'cilës do parti këtu. Më osht' dukë se edhe ata i damtoj, edhe e damtoj vetvetën, 34 vjet e gjysëm kam pagu antarësim por e kam pagu me qenë anëtar i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë edhe tash...

Prandaj nuk jam angazhu në parti politike por jam angazhu në Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut. Aty kom qenë anëtar qysh prej fillimit, kam qenë ndër angazhuesit për themelim të këtij këshilli, dhe prej këtij këshilli nuk jam nda kurrë. Në ndërkohë jam zgjedh nënkyetar, mandej më tepër se 12 vite kam qenë kryetar i KMDLNJ-së në Kosovë. Unë, me ikje të viteve edhe me dalje në skenë të gjeneratave të tjera nuk e kom pa vetën të arsyeshëm që të inkuadrohem edhe ma vonë në këtë këshill.

Mirëpo duhet t'a theksoj se gjatë... mas viteve 2000, në mbështetje të punimeve që kom pas Fakulteti Filozofik, këshilli arsimor shkencor i Fakultetit Filozofik më ka propozu që të jem anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Kom qenë i zgjedhur në vitin 2008 si anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, kurse në vitin 2012 kom qenë i zgjedhur anëtar i rregullt i kësaj akademie, ku edhe sot punoj. Në ndërkohë, më kanë zgjedhë edhe si nënkyetar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Këtë funksion e kryej edhe sot.

Mirëpo, më duket se përvoja ime ka qenë një prej burimeve ose një prej kritereve, që nuk më ka lënë të largohem krejtësisht prej disa aktiviteteve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Në këtë pikëpamje Ministria e Drejtësisë e qeverisë së Kosovës në krye me zavends kryeministrin Hajredin Kuçi, ma kanë besuar vendin e udhëheqësit të delegacionit të Kosovës në biseda me Serbinë për çështjen e të zhdukurve të Kosovës. Osht' viti i tetë që e udhëheqi delegacionin e Kosovës për të gjetë informacione ku janë këta njerëz, ku kanë humbë këta njerëz, si t'u japim eshrat e këtyre njerëzve familjeve, familjarëve të tyre që kanë mbetë gjallë.

Për fat të keq edhe unë kam pasë të zhdukur prej familjes së gjerë timen. Një motër e imja e ka pas të zhdukur dy djemë, një 18 vjeçar një 19 vjeçar. Njërit i janë gjetë pjesë të skeletit, kurse tjetri osht' i humbur edhe sot nuk dihet fati i tij. Edhe sot këtu po vi prej një mbledhje që kemi pas, komisioni ndërministror i Qeverisë së Kosovës për çështje të zhdukurve, sepse me këtë problem mirrem. Nga ana tjetër, po e njëjta ministri më ka angazhu që të jem këshillëtar i lartë shkencor i Institutit për Krime të Luftës në Kosovë. Në këtë institut sot udhëheqi dy projekte, projektin e të zhdukurve dhe projektin e dhunimeve seksuale të grave gjatë zhvillimit të operacioneve luftarakë në Kosovë. Secili osht' më i vështirë se tjetri, osht' më i vështirë se tjetri jo veq për kah pasojet shumë të rënda të tyre, por osht' më i vështirë se tjetri për arsyetë mungesës së burimeve, informacioneve.

Nuk kemi sot informacione ende ku t'i kërkojmë 1740 trupa të pagjeturëve të kosovarëve, kryesisht shqiptarë, u mor vesh. Shumë pak informacione po mund të marrim edhe po mund të gjejmë sidomos për dhunimet e grave. Ka qenë përmasë e theksushme nga ana e individëve edhe kanë botu shkrime të ndryshme madje edhe libra për dhunime grash, por ato kanë qenë libra individual jo libra të institucioneve, sepse ka pas botime se në Kosovë janë dhunuar hënë 20 mijë, herë 30 mijë herë 25 mijë. Gjurmimet në kuadër të këtij projekti ne i kemi gjetë, bie fjala 49 lokacione në krejt Kosovën ku janë bo dhunime. Hajde të themi 50 lokacione, në 50 lokacione në qoftë se jonë dhunu nga 50 gra ato bëjnë 2500 gra, por jo 20 mijë gra të dhunume. Po supozojmë se janë dhunu nga një qind veta në këto lokacione, ato bëjnë pesë mijë, por jo 30 mijë, jo 20 mijë.

Mirëpo unë kisha me thënë se edhe numri meqenëse osht' i rëndësishëm shumë, ose edhe më i rëndësishëm osht' dimensioni human i një lufte të fëlliqt i një lufte të pisët që e ka përfjetu Kosova. Dimensioni shumë i pisët shihet në faktin se gratë që nuk kanë qenë të mbrojtuna, që nuk kanë pas fuqi fizike për t'u mbrojtur, për ta mbrojtur vetëveten edhe për t'i mbrojtur fëmijët e vetë, jonë shfrytëzu për knaqësi të ushtarakëve të ish armatës serbe, jonë zhfrytëzu për knaqësi seksuale të paramilitarëve serb këtu. Jeta e tyre bie fjala, sipas asaj që më ka thënë njëra prej këtyre grave, "Ne gjindemi të gjalla, në mes të vdekurve". E përfjetojnë gjendjen e tyre si të vdekur, por janë të gjalla.

Shumë fat i randë osht' jeta e këtyre grave, por fat edhe më i randë osht' që mjedisit ynë nuk i kupton këto procese. Shumë prej tyre kanë ikë në botë të jashtme, disa prej tyre janë përzanë prej familjeve, ka që jetojnë në varfëri shumë të madhe në vetmi të izoluara etj., etj. Kërkohet që të fshihet ky proces, të mshihet krejtësisht. Nuk osht' për një zbulim të plotë të zhvillimeve ushtarake dhe politike në Kosovë, proceset duhet të njihen. Osht' e rëndë për etikën e mjedisit shqiptar të flitet për dhunime grash, por ky duhet të dihet se në këtë kohë osht' përdorë edhe dhunimi i grave për me mujtë me i mposhtë shqiptarët edhe kërkesat e tyre, kjo duhet të dihet. Përmasat e vërteta, ndoshta nuk mund të njihen kurrëherë edhe vështirë osht' me i ditë.

Pavarësisht ndaj asaj, mjafton që të dihet se në luftën e pisët që osht' zhvillu në Kosovë, jo veq njerëzit janë zhdukë, por eshtrat e tyre janë zhvarrosë. Një pjesë e zhvarrimit të eshtrave të tyre i kanë bart në Serbi në vende të panjohura. Po këto dy përmasa të kësaj lufte që janë zhvillu në Kosovë, e tregojnë një

nivel shumë të ulët etik të luftës të zhvilluar në Kosovë, për të cilën po shkruhet. Por mirë osht' të shkruhet nga ana e institucioneve të veçanta, e jo nga ana e individëve se megjithatë ato janë përshtypje subjektive të individëve, a institucionet kanë kriterë të posaçme të verifikimit të këtyre ngjarjeve.

Unë duke qenë se pata ngelë pa punë, pa të ardhura kur kam dhonë dorëheqje, në ndërkohë pata konkuru në Entin Leksikografik "Miroslav Kérlesha" në Zagreb, për të qenë punëtor i enciklopedisë jugosllave që botohej në atë kohë. Kom qenë i pranuar në konkurs, në këtë mund të them se kom pas edhe pëlqimin prej ish-kryeredaktorit të enciklopedisë shqipe-jugosllave në Kosovë, prej të ndjerit Esat Mekuli në atë kohë, por më kanë njohur edhe punëtorët e arsimit dhe të shkencës së Kroacisë. Kështu që unë njo dhjetë vite të aktivitetit tim i kom kalu në këtë institucion. Pjesën më të madhe, u mor vesh, në kuadër të redaksisë që e kemi pas të lloçume në Prishtinë, por isha në atë kohë më i riu prej këtyre pjesëtarëve tjerë dhe pothuajse për çdo muaj nga një javë e kom kalu në Zagreb në punim të artikujve, të përkthimeve, të botimeve etj., etj., të kësaj enciklopedie.

Ky shërbim më ka ndihmu për së tepërmëti në zhvillimin tim intelektual, edhe vërtetë osht' një përmasë zhvilluese që mjedisi po të shtyn të afirmohesh. Ndryshe osht' të afirmohesh dhe të gjindesh në një Zagreb, e ndryshe osht' të gjindesh në Prishtinë. Neve nuk na i ka onda [pëlqeijnë] ato, por osht' një e vërtetë e këtillë. Unë kur i bashkoj dhjetë vite të mia që i kom kalu në Beograd, edhe dhjetë vite të mia që i kam kalu në Zagreb, ato as më pak as më shumë nuk bojnë, por gjysma e jetës profesionale timen. Gjysmën e kam kalu në këto qendra kulturore, arsimore, politike etj., etj., dhe më kanë ndihmu për së tepërmë... qëndrimi im në institacione kulturore dhe shkencore i këtyre dy mjediseve më të zhvilluara se sa që i kemi pas, edhe sesa që e kemi mjedisin e Kosovës.

Patëm mbërrit t'i botojmë dy vëllime të enciklopedisë jugosllave në gjuhën shqipe, vëllimin e tretë e patëm përgatitë. Por ra lufta edhe më vjen keq që të gjithë atë material që e patëm grumbullu, patëm përpunu, kartotekën, përkthimet... i patën djegë, i patën shkatërru edhe ai material ka humbë përpos dy vëllimeve të enciklopedisë së Jugosllavisë që jonë botu.<sup>5</sup> Edhe ato shënojnë objektivisht, një proces të të zhvillimit të posaçëm të shqiptarëve të Kosovës. Bie fjala enciklopedia, ose ma mirë me thanë tekstet enciklopedike të Tiranës janë botu një vit më vonë se sa osht' botu teksti shqip i enciklopedisë në Prishtinë. U morr vesh, Sami Frashëri ka botu shumë para nesh enciklopedinë e vet por edhe ai e ka botu

<sup>5</sup> "Enciklopedija Jugoslavije" e botuar me 1980 si model bashkëpunimi mes historianëve të kombësive të ndryshme, ishte demonstrimi i pare public i konfliktit etnik që po krijohej në Juosllavi. Anëtarë serbë të bordit redaktues u ankuat pas publikimit të Enciklopedisë në Kroaci, ata riformuluan dy kapitujt "Shqiptarët" dhe "Marrëdhëni Shqiptare-Jugosllave", dhe i'u lutën abonentëve të shtojnë tekste në këtë vëllim. Hyrja "Albanci.lme" (Shqiptarët. Emri), në faqen 72 përcjellet nga faqja 1 e kapitullit "Albanci (shqip Shqiptarët). lme", që vazhdon deri te faqja 12, përtu ndjekur deri te faqja 73. Në hyrjen e pare, Shqiptarët thuhet të kenë prejardhjen nga ilirët, në hyrjen e dytë prezantohen si komb i lindur në Mesjetën e hershme pas një procesi të gjatë asimilimi të ilirëve dhe sllavëve (faqe 3). Një përshkrim i njashëm mund të gjendet pas faqes 86 me hyrjen "Albansko-Jugoslavenski ( Jugoslovenski) Odnosi" (Marrëdhëni Shqiptare-Jugosllave), që përcjellet me faqen 1 me ri-shkrimin e hyrjes së parë.

në gjuhën osmane jo në gjuhën shqipe. Por megjithatë, si shënim historik osht' i vlefshëm sepse Sami Frashëri s` ka qenë turk, Sami Frashëri ka qenë shqiptar dhe zhvillimet enciklopedike fillojnë me emrin e tij jo me emrin e Pajazit Nushit apo të Esat Mekulit, a të ndonjë tjetri çoftë në Tiranë qoftë në Prishtinë.

Po ashtu unë kam pranu që të jem në fillim kryetar i bordit të Universitetit Iliria, në themelimin e këtij universiteti. Më vonë mu osht' ofru vendi që të jem rektor në këtë universitet. Unë e kryej edhe këtë funksion, kam orar të caktuar të punës atje, për një javë tri herë shkoj edhe punoj nga nji deri në tri orë në Universitetin Iliria. Nuk jap mësim por merrem me organizim të punës arsimore dhe shkencore në këtë universitet, në Universitetin Iliria. Përndryshe vendqëndrimi im edhe vendi i punës vertet i imi osht' Akademia e Shkencave, këtu e kam vendin për çdo ditë vi punoj kemi kushte relativisht të mira për punë në këtë akademi.

Kam projekte të mia personale të cilat i'a ofroj akademisë për botim, bie fjala i'a kam ofru botimin e leksikonit të psikologjisë përvit 2014. Unë jom në përfundim të këtij projekti edhe do të i'a dorëzoj për botim Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Punoj edhe në një projekt tjeter po ashtu të psikologjisë e ky projekt ka të bëjë me zhvillim të mendimit popullor të psikologjisë së shqiptarëve edhe me zhvillim të mendimit shkencor të psikologjisë ndër shqiptarët, që osht' trajtu... si janë trajtu fenomenet shpirtërore në bazë të gojdhënavë, në bazë të thashethemeve, në bazë të pleqërive, të bazë të këngëve, në bazë të këngëve epike, këngëve lirike, në folklore si janë trajtu të gjitha këto, si janë trajtu në mendimin shkencor. Nuk osht' e përpunume kjo temë nga ana e të tjerëve mendoj ta përpunoj në qoftë se më mbërrin jeta ime derisa ta përfundoj edhe këtë projekt.

Sikurse përmenda edhe më parë, unë nuk e kam pa të arsyeshme që të angazhohem në parti politike të sistemit shumëpartiak në Kosovë përsye se pjesa dërmuese e jetës sime i ka taku një partie, atë i'a kam lënë historisë le ta çmon. Por kam qenë i inkuadruar qysh prej fillimit përkatësisht qysh prej vitit, prej mbarimit të vitit 1989, në Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut. Aktiviteti im kryesor ka qenë që gjatë zhvillimit të luftës në Kosovë dhe gjatë krejt ngatërrresave e telashevë që i kemi pas në vitet '80-ta dhe '90-ta dhe në vitet e fillimit të 2000-ës, i kom kalu në KMDLNJ. Aty kemi kry mendoj sot një funksion shumë të rëndësishëm për informimin e botës për atë çfarë po ngjet në Kosovë. Kemi dhënë informacione të përkthyera në anglishtë, dhe i kemi përcjellë qoftë në institucionet motra që merren me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut me qendër në Vjenë, në Londër, në Tiranë qoftë me anën e incizimeve televizive të vrasjeve të përndjekurve, të plagosurve, të vrasjeve të ushtarëve shqiptarë në armatën jugosllave etj., etj.

Këto i kemi ndjekë për çdo ditë, patëm mbërrit t'a zgjerojmë këtë këshill me nënëkëshillat tona në të gjitha komunitat e Kosovës. Ato na përcillshin neve informacione çfarë po ngjet në komunë. Ne ato informacione i bartshim në botën e jashtme në sistemin që e kishim të mundshëm për ta bartë qoftë me radio, qoftë me television, qoftë me përkthime, qoftë me dërgim të këtyre informacioneve që qendrat e njohura për mbrojtjen e drejtave dhe lirive të njeriut por edhe në organet federative të Jugosllavisë. Këtu mund të them se vërtet roli i këtij institucioni, jo pse kom qenë unë aty por kemi qenë në themelim një grup

intelektualësh, ka qenë Idriz Ajeti, ka qenë Mark Krasniqi, ka qenë Dervish Rozhaja, ka qenë Rexhep Qosja, ka qenë Zeqirja Cana, ka qenë Imer Jaka, ka qenë Bajram Kelmendi... nuk po më kujtohen emra të tjera që e kemi themelu këtë këshill. Kemi qenë të përndjekur, jemi mundu të mbrojmë... ta mbrojmë veten edhe t'i mbrojmë të tjera për aq sa kemi pas mundësi. Kemi pas humbje shumë të mëdha të njerëzve në këtë këshill, shumë prej aktivistëve tonë kanë qenë të rrahur, kanë qenë të plagosur, disa prej tyre kanë pësu ma të kegen kanë qenë të vrarë. Fjala bjen Bajram Kelmendi ka qenë i vrarë pikërisht për arsyet e angazhimit të tij në Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut. Madje jo vetëm i vrarë ky, por ja kanë vra edhe dy djemtë e tij sikurse osht' e njohur.

Aktin më të rëndësishëm që e kam nënshkru në këtë këshill ka qenë akti i dërguar në Gjykatën e Hagës, në të cilin akt grapi i juristëve tonë të asaj kohe të këshillit në krye me Bajram Kelmendin, Hazi Balen, Lirie Osmanin, Nekibe Kelmendin edhe disa të tjera, i kemi akuzuar drejtpërdrejt një funksionar të lartë të Jugosllavisë së atëherëshme në krye me Millosheviqin. Të gjithë gjeneralët e tij kanë qenë të akuzuar, kanë qenë të akuzuar edhe funksionarët e lartë të qeverisë serbe të asaj kohe. Me i'u thanë [u drejtohet të pranishmeve] të vertetën unë e kam firmos atë akt, por menjëherë kur e kam firmosë, kam ditë që mua do të më burgosin ose do të më ndjekin, ose do të më vrasin. Jam mundu që ta mbroj familjen time që të mos ketë dëme për vete unë i kisha kry të gjitha. Kisha dal edhe në pension, në të vërtet më patën qit me zor në pension. Ato që i kisha mbrri i kisha mbrri, këto që kisha mujtë me i mbrri ndoshta nuk i kisha mbrri kurrë sikur t'më kishin vra. Por kërcënimi ka qenë i pranishëm në këtë rast. Falë këtij angazhimit tim në KMDLNJ edhe tash në këtë moshë nuk më largohet funksioni që i'u thash i angazhimit tim në delegacionin e Kosovës për zbulimin e të pagjeturve për biseda me Serbi. Falë këtij angazhimi tim në këshill, jam angazhu edhe në institutin për krimet të luftës ku i mbaj dy projekte qysh i'u përmenda më parë. Kështu që, angazhimi në Këshill për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut osht' tërhekë zvarë mendikimin e vetë edhe në aktivitetet e mëvonshme të miat.

Nuk jam si me thanë, prej atyre që mendoj se kisha me punu ndryshe; edhe tash me pas qenë e kisha ndjek këtë rrugë që e kam ndjekë. Nuk dyshoj fare që ka qenë rrugë produktive sa për mjedisin ku kam vepru aq edhe më ka kontribu për zhvillimin tim personal. Ky mjedis mu më ka afirmu edhe si profesor i shkollës së mesme edhe si profesor i shkollës së lartë edhe si docent, profesor jo ordinari... profesor ordinari i Universitetit të Prishtinës, profesor ordinari në Universitetin e Tetovës, anëtar korrespondent i akademisë, anëtar i rregullt i akademisë. Ky mjedis mua më ka afirmu edhe këtij mjedisi unë ndij nevojë që t'i ofroj ndihmë aq sa muj. Edhe pse jam pak i shtyrë në moshë, mund të them se shëndeti më ka mbajtë. Do të jem gjithmonë i gatshëm jo vetëm në pikëpamje teorike të ofroj ndihmë, por edhe praktikisht të shkoj me i pa ku janë varrezat masive, të shkoj më i pa eshtrat... institutin për psikiatri ligjore në Prishtinë, të shkoj në institutet të Eulex-it për t'i pa skeletet e njerëzve tanë, qysh mund të merrimë t'i identifikojmë.

Kom shku në Bosnjë për të pa të njëjtën gjë etj., etj., prandaj nuk më pengon edhe puna fizike deri sa të më mban shëndeti. Por puna intelektuale më fort më mban se sa që më mban puna fizike. Kam një sistem

të punës intelektuale timen veq tash të stabilizohem që edhe me deshtë nuk mundem me hekë. Bie fjala unë veq tri orë në mbrëmje bëjë gjumë, prej orës tre mbas mesnate deri ne orën shtatë-tetë unë puno. Derisa të tjerët flejnë sepse atëherë kam kohë kur unë mund shfrytëzoj bibliotekën pa zhurmë, pa telashe tjera. Kështu që, unë edhe kur nuk nuk më punohet, unë prej orës tre mbas mesnate nuk mund të fle, sepse jam mësu dhe, me dhjetra vite të zgjohem të punoj. Po ashtu, puno edhe sot në të njëjtin kuadër në të njëjtin sistem, punë të ndryshme intelektuala, po punë që kanë të bëjnë drejtpërdrejtë me profesionin tim.

**Anita Prapashtica:** Na tregoni cilat ishin andrrat si i ri.

**Pajazit Nushi:** Andërrat e mia? Qe besa, me këtë po kuptoj cili kish me qenë vizioni im i ardhshëm, si me thënë përgjithësisht edhe si e kuptoj ardhmërinë jo veq timen por edhe të tjerëve. Unë kam kalu nëpër situata shumë të ndërlikuara politike, ushtarake, ekonomike, kulturore etj., etj. Edhe kur sot i përceptoj situatat e tashme politike, jo veq në Kosovë por edhe jashtë Kosovës, më duket se duhet të bëhet përpjekje shumë ma serioze për ruajtjen e paqes dhe të zhvillimit të ekuilibruar, në pjesën juglindore të Evropës. Nuk mendoj se zhvillimet e matutjeshme mund të shkojnë me një butësi edhe me një lehtësi qysh njerëzit kanë dëshirë, edhe qysh njerëzit supozojnë.

Nuk kisha me qenë në gjendje me i'u përgjigjë pyetjes, "Për cilat shkaqe po mendon kështu?" Unë po i përceptoj këto zhvillime te ne, zhvillime që shkojnë prej një ekstremi në ekstremin tjetër, zhvillime që parlamenti ta përkrahë ligjin për amnesti, Vetëvendosja qohet e bënë demonstrata kundër këtij ligji. Çka ka këtu të vërtetë? Populli duhet ta dijë këtë. Duhet ta dijë ka të angazhohet, mbërritja e marrëveshjeve te ne osht' proces shume i ndërlikuar, në Kosovë po aq më i ndërlikuar se sa në vende të tjera. Po zhvillimi demokratik, por zhvillimi demokratik nuk nënkupton edhe fyerje edhe ofendime edhe nxjerrje të njerëzve jashtë shtratit të mundshëm për diskutime etj etj. Nuk osht' veq situatë e Kosovës. Shiqoni edhe në Shqipëri osht' e njëjtë situatë, ne jemi në fund të fundit i njëti komb, nuk mund të ndryshojmë edhe në pikëpamje shumë mes njani- tjetrit. Por nuk janë të mira, nuk janë të mira, prandaj edhe andrra e dëshirueshme e ime kishte me qenë sikur në sistemin pluralist dhe në sistemin demokratik, marrëveshjet të jenë ma racionale dhe ma të frytshme.

**Anita Prapashtica:** Cilat kanë qenë andrrat tuaja? Dhe, a osht' Kosova si e keni paramendu?

**Pajazit Nushi:** Andrra ime e parë në rini ka qenë që të bëhem një profesor i shkollës së mesme i mirë, më i'u thanë të vërtetën [i drejtohet të pranishmeve], kjo ka qenë ide e fiksume. Të mbërrij të bëhem një punëtor i mire, një profesionalist i mirë, në nivelin që kemi ditë atëherë. E ky nivel që kemi ditë atëherë, maksimumi ka qenë profesor i shkollës së mesme i mirë, ky ka qenë ai nivel të cilin e kemi andërru gjithmonë, gjenerata ime së paku. Kurrë, me më pas pyet, nuk kisha thanë se do të mbërrij që të jem jo si profesor i shkollës së mesme i mire, se kam marrë shumë falënderime edhe si me thanë edhe dekorata të ndryshme për krejt punët që i kam ba që nuk i përmenda këtu. Por në atë kohë nuk kisha besu as në

andërr që do të mbërrij të jem edhe profesor universiteti edhe nënkyetar i Akademisë së Shkencave, Allahu na ruajt, këtë jo!

**Anita Prapashtica:** Çka konsideroni si arritjen më të madhe?

**Pajazit Nushi:** Arritjen time ma të madhe kisha me objektivizu, nënkyetar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, objektivisht me pa kjo osht'. Kjo osht' një shkallë që tregon shumëçka. Unë kam edhe aspirate të tjera individuale, bie fjala pak përpara e përmenda, që më shumë se 30 vite punoj në hartimin e këtij leksikoni të psikologjisë. Në 1987-tën ma ka pas botuar Instituti Albanologjik i Prishtinës një fjalor të psikologjisë. Në atë fjalor kom ba ndryshime, polotësime, kam shënu burime të reja ku kam shku kam marrë materiale të reja për leksikon. Në qoftë se mbërrij ta përpiloj edhe ta përfundoj këtë leksikon, kish me qenë një nivel i aspiratës sime reale, sepse jam ka përfundimi, mendoj se mund ta përfundoj. Mirëpo, kam dëshirë sikur të mbërrija të japi një pasqyrë të qartë qysh kemi kalu na shqiptarët prej mendimeve religioze për shpirtin, deri te mendimet shkencore për psiqikën e njeriut, për proceset psiqike, për sjelljet e njeriut, për temperamentin e njeriut, për personalitetin e njeriut, për karakterin e njeriut për tiparet e karakterit të njeriut etj., etj.

Mirëpo kjo që thashë qysh tash po më dëshpëron ngapak sepse ne kemi pas një periudhë shumë të gjatë kur jemi marrë me mendime popullore për shpirta për andrra, për karakter të njerëzve, për besë, për mikëpritje etj., etj. Stadi ose faza e zhvillimit shkencor për këto dukuri te ne osht' e vonuar, për të mos thanë shumë e vonuar por osht' e vonuar, osht' një fakt që nuk osht' për t'u mohu sikurse që nuk osht' për t'u mohu edhe njerëzit tonë, edhepse kanë qenë në nivel të ulët arsimor edhe kulturor, gjithmonë janë marrë me gjurmime, me hulumtime, ashtu qysh kanë ditë, "Çka domethanë kjo andërr e parë mbrëmë", fjala bjen, qysh e komenton ti këtë dukuri që njerëzit sot besojnë dikush në këtë varr, dikush në atë tyrbe, dikush në kishë, dikush në atë njeri etj., etj. Njerëzit tanë janë marr me këtë dukuri, madje ajo që osht' për t'u theksu edhe me këtë rast në mesin e njerëzve të pa shkolluar shqiptarë të mjedisit të Kosovës, shumë të lanun, ka njerëz pleqnar shumë të zgjuar, shumë të menqur që i ka shënu historia e zhvillimit të mendimit të shqiptarëve. Ka aq njerëz të menqëm që i kanë zgjidhë problemet shumë të ndërlikuara familjare, ndërnjerzore, ndërfisnore që sot as doktorët e shkencave juridike nuk mund t'i zgjidhin aq lehtë. Çashtjet pronësore, mosmarrëveshjet pronësore kanë qenë shumë të vështira në Kosovë.

Në familjet e mëdha osht' ardhë rasti i ndarjes, aty vështirë osht' që të gjindet ndonjë kriter objektiv, ose unë kam mendu kështu, ti ke mendu ashtu. Mirëpo, njerëzit tonë kanë ditë t'i zgjidhin me shumë sukses, shumë me sukses. Bi e fjala, unë i di disa prej literaturës, jo që kam pas rast të njihem me ta, një Binak Alia i paskan thënë, ka zgjidh pleqëritë më të ndërlikuara të vrasjeve në mes njerëzve. I ka zgjidhë në atë mënyrë duke i mbrojtë njerëzit që të mos vriten ma tutje, ai osht' synimi kryesor, se jo dënnimi, "E ke ba këtë ti duhet me u dënu me vdekje." Këtë mund ta bëjë çdokush, por t'i matë njerëzisht fajet edhe të i'a përcakton secilit fajin që e ka ba duke mbrojtë dinjitetin njerëzor të tij edhe duke mbrojtur qenjen e tij, ajo nuk ka qenë punë e vogël. Nuk ka qenë veq Binak Alia, kanë qenë disa veta prej Drenicës sonë që i kanë zgjedhë këtë probleme shumë ma me sukses sesa i zgjidhim sot na këtu po e shti edhe veten.

Çka do të thotë, kanë pas njerëz të zgjuar, ata me të vërtetë s'kanë ditë shkrim e lexim por kanë ditë të mendojnë shumë mirë. Mendimi i tyre nuk ka njoftë simbole, nuk ka njoftë numra me shkru, nuk i ka njoftë shkronjat, por ka njoftë kuptimin e problemit, thelbin e problemit dhe qysh ta zgjidhin atë problem. Ne kemi edhe sot njerëz të këtillë, por sot i kemi njerëz të këtillë që mendimin edhe intelektin e tyre e zhvillojnë me anë të simboleve me anë të një sistemi tjetër.

Bie fjala, jam kryetar i një bordi të një projekti për fëmijë me inteligjencë të jashtëzakonshme në Kosovë, që dy vjet zbatohet ky projekt. Ata fëmijë kur bisedon me ta, unë vetë po duhet të jem shumë i kujdeshshëm sepse janë në gjendje ta kapin problemin menjëherë. Fëmijë me inteligjencë të jashtëzakonshme! Ata nuk dijnë fjala bjen, të vizatojnë, por janë në gjendje ta zhvillojnë një sistem të problemeve matematikore... profesorët e Universitetit të Prishtinës. Dua të them se mjedisi ynë ka edhe këtë kategori, në të cilën kategori besoj se institucionet tona do të angazhohen gjithnjë e më tepër, sepse zhvillimi individual i këtyre fëmijëve kur të rriten këta të bahan udhëheqës të vërtetë të një vendi. Vendin asnjëherë nuk e kanë udhëheqë njerëz që s'kanë pas inteligjencë mbi mesatare, e aq më pak inteligjencë mesatare. Vendin e kanë udhëheqë mirë dhe me sukses ata që kanë pas intelekt të jashtëzakonshëm, intelekt të fuqishëm etj., etj.